



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Gjuhë Angleze”

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Elida TABAKU

Dr. Rudina VRIONI

Prill / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Gjuhë Angleze”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Gjuhë Angleze”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr 801, datë 20.12.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 38, datë 14.06.2018 Miratuar me Shkresë të MASR Nr. 7238/1 Prot., datë 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 287, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Studime me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit	18 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2021-2022: 58 studentë; Viti akademik 2022-2023: 50 studentë; Viti akademik 2023-2024: 31 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar në vitin 2006 me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 801, datë 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”. UAMD është akredituar në nivel institucional, për herë të parë me vendimin Nr. 10, datë 07.04.2017 dhe riakredituar me vendimin Nr. 18, datë 24.03.2022 për “Akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës”, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati i vlefshmërisë deri më 23.03.2026.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, përbëhet nga 5 fakultete:

1. Fakulteti i Biznesit;
2. Fakulteti i Shkencave Politike – Juridike;
3. Fakulteti i Studimeve Profesionale;
4. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
5. Fakulteti i Edukimit;

Programi Bachelor në “Gjuhë angleze” ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD). Programi i studimeve të ciklit të parë, Bachelor në “Gjuhë Angleze” është hapur me Urdhër Nr.1784, datë 20.03.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe riorganizuar me Urdhër, Nr. 31, datë 29.12.2017 të MASR. Programi përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të pajisë studentët me njohuritë bazë që i formojnë ata si profesionistë të gjuhës angleze. Kurrikula e programit është e strukturuar në Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve në 180 ECTS dhe ofrohet me kohë të plotë në tre vite akademike.

Programi ofron kualifikim të nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe i përgatit të diplomuarit në të për të përvijuar studimet në programe të ciklit të dytë. Në programin në fjalë janë regjistruar 58 studentë në vitin akademik 2021-2022, 50 studentë në vitin akademik 2022-2023 dhe 31 studentë në vitin akademik 2023-2024. Për realizimin e programit njësia ka angazhuar aktualisht 22 Personel Akademik Efektiv (PAE), 25 personel akademik me kontratë (PAK) dhe 2 personel ndihmës akademik.

Qëllimi kryesor i programit është të përgatisë studentë të aftë për t’ju përgjigjur kërkesave të reja të tregut dhe zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vend, duke i pajisur studentët me njohuri të qëndrueshme jo vetëm në fushën e gjuhës angleze, por edhe në përdorimin e mjeteve të reja teknologjike brenda dhe jashtë procesit mësimor.

Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akreditimit po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të Universitetit Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës për “Përcillen formularët e “Aplikimit për Akreditimin e Programeve të studimit”, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, drejtuar ASCAL-it, më datë 21.01.2022, Nr. 121 Prot 121.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë angleze”. Bazuar në Urdhër Nr.44, Datë 14.04.2023, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) ka në përbërje: Prof. Dr. Elida Tabaku dhe Dr. Rudina Vrioni. Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Mars 2023 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD) për të përmbushur synimet si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm është i shoqëuar nga një dosje prej 154 evidencash, që mbështesin kuadrin ligjor, menaxhimin institucional dhe administrimin e këtij programi, në lidhje me rregulloret dhe planet strategjike të zhvillimit, stafin akademik dhe studentët, objektivat e programet dhe rezultatet e të nxëniet, aktorët mbështetës, sigurimin e cilësisë dhe administrimin financiar dhe infrastrukturor në dispozicion të tij. Shkrimi i RVB reflekton profesionalizëm, kujdes në analizën e përmbushjes së standardeve dhe vëmendje në pasqyrimin konkret të gjetjeve në pjesën përshkuese. GVB reflektoi gjithashtu njohje të sa më sipër edhe gjatë intervistës me GVJ.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 4 dhe 5 Tetor 2023, GVJ organizoi takime me Dekanin dhe Përgjegjës të Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe NJBSC, stafin akademik dhe studentët, stafin administrativ në shërbim të studentëve, përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore, Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve dhe Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit për Ciklin I dhe II. GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët, sallat e internetit dhe të kompjuterëve, etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Pas vizitës në institucion, GVJ krijoi ide më të qarta në lidhje me përgjegjësitë, procedurat, organizimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe burimeve njerëzore në dispozicion të tij. Takimet u shoqëruan me diskutime të shumta dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.02.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19/39 Prot, datë 23.02.2024. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka dërguar në ASCAL më datë 11.04.2024, nëpërmjet shkresës me Nr. 499/1 prot, datë 04.04.2024 “Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

Për Komentin që i përket Standardit II.4, kriteri 2: GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron formulimit në tekst, duke u nisur nga karakteristikat e programit, raporti i vlerësimit të studentit (në këtë program studimi), duhet të shikohet dhe t'i lihet më shumë vend në vlerësim, vlerësimit të aftësive komunikative. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknologji Informativë”


I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” ofrohet në përputhje me përcaktimet e Statutit dhe të Planit Strategjik të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, (UAMD) si dhe me misionin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja (DGJH), si njësi përbërëse e tij. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribuon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët, me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin dhe modernizimin e vendit.
	Evidencë-2-Statuti UAMD, 2018. Evidencë-3-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025. Evidencë-12-Strategjia e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2022-2025.

<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se misioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për formimin e studentëve. Në bazë të programit mësimor të hartuar nga institucioni vërehet mbulimi i njohurive bazë dhe atyre specifike në fushën e edukimit, duke synuar arritjen e standardeve të larta akademike.</p> <p>Në Planin Strategjik të UAMD (2020 – 2025) , GVJ konstatoi se Institucioni karakterizohet nga diversiteti dhe larmia e programeve të studimit që ofrohen në disiplina të ndryshme, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ekonomi/shkenca ekonomike (biznes/sipërmarrje, financë-kontabilitet, turizëm. • Shkenca sociale e humane (Edukim/Pedagogji, Sociologji/Probleme Sociale, • Shkenca politike e juridike (Drejtësi, Administrimi Publik/Administratë. • Teknologji dhe Informacion (Shkenca Kompjuterike, Teknologji Informacioni); Shkenca Mjekësore (Mjekësi/Shëndet Publik); Shkenca të natyrës dhe inxhinierike (Shkenca Inxhinierike, Mekanikë, Transport). <p>Misioni i Universiteti “Aleksandër Moisiu”, është të sjellë shkencë dhe punësim, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, të studuarit gjatë gjithë jetës, aftësimi të personelit akademik. Për sa më lart, programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.</p> <p>Evidencë-2-Statuti UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-3-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikën e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve. Ky program studimi synon të përgatisë specialistë të gjuhës angleze, për t’iu përgjigjur nevojave kombëtare e rajonale.</p> <p>Evidencë-3-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD.</p>




	Evidencë-153-Studimi i tregut për BA Gjuhë Angleze.			
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UAMD ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze".</p> <p>Nga të dhënat që jepen në DVV, rezulton numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë në disiplinat specifike të këtij programi studimi. Në këtë program janë angazhuar 18 Personel Akademik Efektiv (PAE), 2 personel akademik me kontratë (PAK) për vitin akademik 2022-2023. Stafi akademik ka kualifikimin e duhur për formimin e njësisë bazë si dhe angazhimi i tyre akademik është në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.</p> <p>Evidencë-46-Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe me Kontratë në Njësine Bazë, 2022-2023.</p> <p>Evidencë-130-CV e Personelit Akademik.</p> <p>Evidencë-65-Analiza Vjetore e Njësies Bazë në lidhje me programin Bachelor "Gjuhë Angleze" 2021-2022".</p>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësies kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" (shih RVB) është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Edukimit si dhe atë të njësies bazë, Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-152-RVB, Bachelor në Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-2-Statuti UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-12-Strategjia e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2022-2025.</p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit, Bachelor në "Gjuhë Angleze" që ofrohet në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, është në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.</i></p> <p><i>Programi i studimit ofrohet nga njësi bazë dhe kryesore që kanë të njëjtën fushë akademike me atë të këtij programi studimi. Mbështetur në sa më sipër, GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht





				X
--	--	--	--	---

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, Statutin dhe rregulloren e UAMD, si dhe aktet rregullatore specifike. GVJ analizoi gjithashtu edhe përgjigjet e grupeve gjatë takimeve të organizuara në institucion dhe konstaton se UAMD siguron më së miri marrëdhëniet brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të UAMD ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukturës.</p> <p>Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren e tij. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Gjuhëve të Huaja, menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Angleze”, i cili ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite. Analizat mësimore vjetore të punës së njësisë, të grupeve mësimore-kërkimore dhe personelit i shërbejnë përmirësimit të punës në lidhje me zbatimin e programit të studimit. Vërehet bashkëpunim me strukturat e institucionit (Njësia e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokolli, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë etj.) si dhe departamentet e tjera në Fakultetin e Edukimit dhe në tërësi në UAMD.</p> <p>Evid. 11. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike DBNjJ</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor “Gjuhë Angleze”, 2019.</p> <p>Evidencë-65-Analiza Vjetore e Njësisë Bazë në lidhje me programin Bachelor “Gjuhë Angleze” 2021-2022”.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UAMD ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi si me</p>

<p>bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>institucione të tjera të arsimit të lartë, ashtu edhe me subjekte ekonomike private dhe institucione të tjera shtetërore.</p> <p>Nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën përgjegjëse për marrëdhëniet më jashtë, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL vendase dhe të huaja dhe me kompani biznesi. Gjithashtu vihet re edhe rritja e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+.</p> <p>Evidencë-122-Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s.</p> <p>Evidencë-63-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR.</p> <p>Evidencë-123-Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD 2015-2021.</p>			
<p>Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Gjuhë Angleze” i ofruar nga UAMD, parashikon në planin mësimor lëndën “Praktikë profesionale”. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, me kompani publike dhe private të cilat përdoren zyrtarisht për zhvillimin e praktikave,</p> <p>Evidencë-36- Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-12-Strategjia e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2022-2025.</p> <p>Evidencë-63-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në fund të vitit akademik, njësia bazë realizon analizën e punës mësimore dhe shkencore ku përveç aspekteve të tjera të punës që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e këtij programi studimi, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit. Në këto analiza evidentohen efektet pozitive dhe përfitimet e këtyre marrëveshjeve në tërësi në funksion të realizimit të qëllimeve të këtij programi studimi, por edhe të evidentimit të mangësive të tyre.</p> <p>Evidencë-65-Analiza Vjetore e Njesisë Bazë në lidhje me programin Bachelor “Gjuhë Angleze” 2021-2022”</p> <p>Evidencë-12-Strategjia e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2020-2025</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere si dhe aktorë të tregut të punës dhe i analizon ato në mënyrë periodike. Mbështetur në këto gjetje, GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) si dhe sistemin amerikan UsCr.</p> <p>Programi ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” përmban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar. Programi është i organizuar në lëndë dhe module të cilat pasqyrohen në Planin Mësimor, ku krahas tyre jepen në mënyrë të hollësishme edhe kreditet përkatëse sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) si dhe të dhëna të tjera mbi tipologjinë e lëndës, semestrin apo vitin akademik kur mund të frekuentohet, ngarkesën semestrale etj.</p> <p>Nga kontrolli i syllabuseve të lëndëve të cilat zhvillohen në vitin e parë, u vu re se në disa prej tyre është parashikuar numri total i krediteve ECTS, por jo ndarja e tyre në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime/Seminare, Laboratorë, etj.</p> <p>Në planin mësimor është parashikuar vetëm numri total i krediteve ECTS dhe ndarja në orë. Nuk ka të parashikuara aktivitete didaktike si Seminare, Laborator apo detyra/projekte kursi, praktika etj. Në statutin e UAMD, neni 72, pika 4 shpjegon se lëndët zhvillohen si:</p> <p>a) Në orë mësimi leksionesh;</p>


	<p>b) Në orë mësimi seminaresh;</p> <p>c) Në orë mësimi të integruara të leksioneve me seminare;</p> <p>d) Në formën e moduleve dy-tre javore;</p> <p>e) Me trajnim profesional të zhvilluar në institucione dhe kompani partnere të UAMD.</p> <p>Në rregulloren e FE-së, neni 61, pika 4, shpjegon se lëndët mësimore organizohen si ndërthurje e elementëve të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. Ato mund të jenë të ndërthurura si:</p> <p>a) leksione;</p> <p>b) seminare;</p> <p>c) orë të integruara të leksioneve me seminarët;</p> <p>ç) ushtrime;</p> <p>d) laborator;</p> <p>dh) projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup;</p> <p>e) provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare;</p> <p>ë) në formën e praktikës profesionale të zhvilluar në laboratore të FE-së, dhe/ose në institucione dhe kompani me të cilat FE/UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi;</p> <p>f) konsultime individuale ose në grupe me pak studentë;</p> <p>g) apo çdo formë tjetër të miratuar nga FE.</p> <p>Ndarja e orëve mësimore sipas elementëve të mësipërme të studimit për çdo kurs, përcaktohet në kurrikulën e programit të studimit të miratuar nga departamenti përkatës, në bazë të krediteve që i janë caktuar disiplinës. Mungesa e specifikimit të numrit të krediteve ECTS të secilës lëndë në aktivitetet e saj didaktike formuese, në syllabus, potencialisht është një mangësi në aftësinë e transferimit të studimeve nga UAMD drejt institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>GVJ rekomandon institucionin të unifikojë syllabuset dhe planin mësimor në përputhje me VKM nr.41 e ndryshuar duke saktësuar kreditet dhe orët mësimore për secilin aktivitet didaktik (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj).</i></p>
	<p>Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.</p> <p>Evidencë-16-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-datë-24.1.2018.</p>




	<p>Evidencë-56-Kriteret e Transferimit të Studentëve në Bachelor 2021-2022.</p> <p>Evidencë-55-Miratimi i Kritereve të Pranimit nga Senati Akademik.</p> <p>Evidencë-36-Plani mësimor</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Qëllimi i programit të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” është të ofrojë një formim bazë në fushën e gjuhës angleze, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi në aspektin e punësimit, dhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në gjuhë angleze apo programe të tjera. Në përfundim të studimeve 3-vjeçare studentët:</p> <p>Pajisen me njohuritë dhe aftësitë bazë të zbatueshme në përputhje me formimin e tyre të përgjithshëm gjuhësor, letrar, historik dhe të qytetërimit anglishtfolës;</p> <p>-Aftësohen për të komunikuar dhe kaluar nga një gjuhë në tjetrën, në kontekste dhe fusha të ndryshme;</p> <p>-Zotërojnë njohuri për disiplinat e programit të studimit (gjuhësi, letërsi, histori dhe qytetërim britanik e amerikan) nëpërmjet gjuhës B (anglisht);</p> <p>-Zotërojnë aftësinë për të komunikuar dhe kaluar nga një gjuhë në tjetrën, në kontekste të ndryshme dhe në fusha të ndryshme;</p> <p>-Janë të aftë të identifikojnë dhe korrigjojnë të metat (gjuhësore dhe / ose logjike) në tekstet e natyrave dhe stileve të ndryshme;</p> <p>-Zotërojnë në nivel të përparuar gjuhën angleze si gjuhë B;</p> <p>Evidencë-57-Shpërndarja e Kuotave të pranimit të studenteve Bachelor 2022-2023.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor “Gjuhë Angleze”, 2019.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, por edhe në syllabuset e lëndëve, vërehet se secila lëndë ka të përcaktuar objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët në total kreditesh dhe orësh në auditor. Programi i studimit “Gjuhë Angleze” mbështetet në bazën ligjore për sa i përket veprimtarive formuese, ku lëndët/modulet i gjejmë të grupuara sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Për programin e studimit në fjalë, kurrikula mësimore me disiplina dhe plani mësimor mbështetet në këto kategori:</p>




	<ul style="list-style-type: none"> ● Kategoria A që përfshin Lëndët Bazë: 20% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 15%-20%. ● Kategoria B që përfshin Lëndët Karakterizuese: 51% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 50%-55%. ● Kategoria C që përfshin Lëndët Ndërdisciplinore /Integruese: 14% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 12%-15%. ● Kategoria D që përfshin Lëndët Plotësuese: 11% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 10%-15%. ● Kategoria E që përfshin Lëndët Përmbyllëse: 3% të krediteve, duke plotësuar kriterin e krediteve 3%-5%. <p>Kurrikula e këtij programi është hartuar duke mbajtur parasysh që çdo kurs të zërë vendin që i takon në kuadër të veprimtarive formuese.</p> <p>Evidencë-37-Ndryshimet ne planin Mësimor Gjuhë Angleze. Evidencë-16-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-datë-24.1.2018.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Plani mësimor parashikon në total 29 lëndë mësimore si dhe tezën e diplomës/Provimi formimi, për një total prej 30 lëndë/module didaktike të ndara në veprimtari formuese në kategoritë A-E sipas VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar. Punimi i diplomës/provimi formimi është parashikuar si detyrime përmbyllëse me 6 kredite ECTS në kategorinë “E”.</p> <p>Programi i studimit “Gjuhë Angleze” përmban ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale përgjatë tre semestrave, të ndarë ndërmjet orëve në auditor dhe orëve në institucione të ndryshme arsimore të sektorit publik ose privat me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Evidencë-16-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-datë-24.1.2018.</p> <p>Evidencë-36- Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimit të studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzime</p>	<p>Dosja e programit të studimit “Gjuhë Angleze” përmban elementët e mëposhtëm: emërtimin e programit, objektivat formuese, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë përkatës, ngarkesën mësimore dhe organizimin e saj në ECTS (planin mësimor), kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, kuotat dhe kriteret e pranimit, kodin e etikës akademike, detyrimet përmbyllëse, diplomën dhe suplementin.</p> <p>Evidencë-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.</p>




të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Referuar dokumentacionit shoqërues të këtij raporti, të vëna në dispozicion nga UAMD dhe duke i krahasuar ato me programe të ngjashme studimi të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, vihet re se plani mësimor në emërtime lëndësh, por edhe në shpërndarje, është i ngjashëm me programet e ofruara nga IAL të tjera brenda vendit dhe në përputhje me objektivat e formimit të këtij programi studimi. Evidencë-36- Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Përsa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentacionit shoqërues si dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi është përcaktuar nga UAMD. UAMD ka hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve që ofron, ku programi në fjalë mban kodin UAMD-BCH-60231-ANGL87 . Evidencë-15-Kodifikimi i Programeve UAMD. Evidencë-7-Rregullore FE, 2019. Evidencë-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet.
Konkluzione	<i>Lëndët dhe formimi në tërësi i programi të studimit, janë në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimi dhe të ngjashme me ato të ofruara nga IAL të tjera.</i> <i>Në planin mësimor dhe në disa syllabuse nuk janë të saktësuara kreditet dhe orët në auditor për aktivitetet didaktike (Leksione, seminare, ushtrime, laborator, detyra/projekte kursi, praktika etj.) që parashikon çdo lëndë sipas VKM 41 (e ndryshuar) duke saktësuar kreditet dhe orët mësimore për secilin aktivitet didaktik. <u>Institucioni duhet të unifikojë planin mësimor dhe syllabuset duke specifikuar aktivitetet didaktike për secilën</u></i>




	lëndë. Për këtë arsye, GVJ konstaton se ky standard përmbushet kryesisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushet kryesisht dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																				
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushet detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.18, datë 24.03.2022 që akrediton në formë institucionale, me vlefshmëri 4 vite, për periudhën nga 24/03/2022 deri në 23/03/2026.</p> <p>Fakulteti i Edukimit, si njësi kryesore, dhe njësia bazë e Gjuhëve të Huaja, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për programin e studimit "Gjuhë Angleze", përmbushin të gjitha detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike si dhe vlerësimin e akreditimit. FE ka në përbërje shtatë njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Pedagogjisë; 2. Departamenti i Gjuhës Shqipe; 3. Departamenti i Letërsisë; 4. Departamenti i Gjuhëve të huaja; 5. Departamenti i Sociologjisë; 6. Departamenti i Psikologjisë; 7. Qendra e edukimit në vazhdim; <p>Fakulteti i Edukimit, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 125 pedagogë, nga të cilët 79 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 46 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:</p> <p>Te dhenat e Fakultetit 2020-2023 (1)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakulteti i Edukimit</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>19</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>52</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>5</td> <td>34</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>79</td> <td>46</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Edukimit		PAE	PAK	Prof.Dr	3	1	Prof.Asoc	19	4	Dr/PhD	52	7	Msc	5	34	Gjithsej	79	46
Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Edukimit																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	3	1																			
Prof.Asoc	19	4																			
Dr/PhD	52	7																			
Msc	5	34																			
Gjithsej	79	46																			

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Departamenti i Gjuhëve të Huaja, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	1	0	1	0	1
Prof. Asoc.	2	1	2	2	4	0
Dr./PhD.	20	2	19	3	14	5
Msc.	2	27	2	23	4	19
Totali	24	31	23	29	22	25

Departamenti është i organizuar në katër grupe mësimore me karakter kërkimor-shkencor, përkatësisht: Grupin e shkencave gjuhësore, grupin e shkencave letrare, grupin e shkencave të edukimit dhe atë të historisë dhe kulturës. Departamenti angazhon staf në përputhje me fushat akademike dhe kërkimore që përfshin programi. Personeli akademik ka aftësitë dhe kualifikimet e duhura për realizimin e programit. Departamenti angazhon disa lektorë të ftuar. Njësia bazë përmbush kriteret minimale të parashikuara në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësive bazë.

Evidencë-2- Statuti UAMD, 2018

Evidencë-8-Struktura e UAMD 2018.

Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.

Evidencë-48- Akademik Efektiv dhe me Kontratë në Program, 2021-2022.


Evidencë-51- Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe me Kontratë në Njësine Bazë, 2022-2023.

Evidencë-71- Grupet mësimore në Departament.

Evidencë-154- Tabela 1.3


Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse

Fakulteti i Edukimit angazhon në ndihmë të procesit akademik, për Departamentin e Gjuhëve të Huaja, 2 personel ndihmës




<p>për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>akademik duke përmbushur kështu edhe detyrimet ligjore në angazhimin e stafit ndihmës akademik.</p> <p>Evidencë-45-Numri i Personelit Ndihmës Akademik në Departament dhe Program</p>		
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazuar në RVB, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në përputhje me objektivat e tij për realizimin e objektivave të programit të studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze", ka të përcaktuar objektivat e Koordinatorit të programit të studimit. Roli i tij/saj është i përcaktuar në Rregulloren e njësisë bazë.</p> <p>Koordinatori për programin e studimit Bachelor në "Gjuhë Angleze" është Përgjegjësi i Departamentit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ecurisë së programit sipas Rregulloreve të Universitetit, Rregulloreve të Departamentit dhe programit të studimit.</p> <p>Evidencë-17-Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fakulteti i Edukimit në Universitetin "Aleksandër Moisiu" në tërësi, dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë. Lidhur me këtë standard, GVJ e konsideron atë të përmbushur plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi II.3</p>	
<p>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në FE, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në “Gjuhë Angleze”, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, disponon dhe ka vënë në dispozicion informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, si rregulloren dhe programin mësimor.</p> <p>Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor “Gjuhë Angleze”.</p> <p>Evidencë-36- Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-16-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-datë-24.1.2018.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra.</p> <p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi. Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite. Në vitin e tretë është parashikuar punimi i diplomës ose provimi i formimit me 6 kredite ECTS. Për çdo lëndë, në planin mësimor është parashikuar ngarkesa mësimore në auditor si ngarkesë totale dhe ajo jashtë tij. Programi mbështetet në planin mësimor. Plani mësimor paraqet informacione që lidhen me ngarkesën mësimore, titullin e veprimtarisë formuese, kategorinë e veprimtarisë, frekuentimin, kreditet e lëndëve, orët mësimore në javë, semestrin kur mund të frekuentohet një lëndë e caktuar, numrin e orëve në auditor ose për studim individual. Në planin mësimor specifikohen edhe instrumentet e vlerësimit të njohurive dhe vlerësimi jepet sipas sistemit shqiptar dhe atij amerikan duke krijuar lehtësira për studentët që duan të transferojnë apo të ndjekin studimet jashtë vendit. GVJ konstaton që syllabuset paraqesin informacion rreth mënyrës së vlerësimit në notë, por jo me shkronja sipas sistemit Amerikan.</p> <p><i>GVJ sugjeron që syllabuset të paraqesin informacion rreth mënyrës së vlerësimit në notë dhe me shkronja sipas sistemit Amerikan, në përputhje me aktet e tjera rregullatore të</i></p>





	<p><i>institucionit, sikurse është rregullorja e njësisë kryesore dhe suplementi i diplomës.</i></p> <p>Evidencë-37-Ndryshimet ne planin Mësimor Gjuhe Angleze.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni, dhe në veçanti, njësia bazë propozon për çdo vit kriteret specifike të pranimit bazuar në cilësinë dhe programet e maturantëve dhe nevojat e tregut për profilin Bachelor në “Gjuhë Angleze”. Në rregulloren e njësisë kryesore dhe në atë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e tyre. Kriteret specifike dhe mënyrat e vlerësimit dhe njohjen e krediteve propozohen nga njësia bazë dhe janë pjesë e procedurës së ekuivalentimit të njohurive të mëparshme të studentit nga komisionet ad-hoc që ngrihen kur ka kërkesa për transferime.</p> <p>Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor “Gjuhë Angleze”.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, janë paraqitur syllabuset të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E. Syllabusi jep informacion mbi pedagogun që do të zhvillojnë modulën/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre, si dhe literaturën.</p> <p><i>Megjithatë, në disa syllabuse të vitit të parë nuk është caktuar qartë ndarja në kredite e aktiviteteve didaktike formuese, por është paraqitur vetëm numri i krediteve në total.</i></p> <p>Evidencë-16-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-datë-24.1.2018.</p> <p>Evidencë-41-Model Syllabusi sipas VKM-se nr 41.</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, vërejmë se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhohet në përditësimin e vazhduar të programit të studimit që ofron. Në veçanti, në fund të vitit akademik, stafi akademik i përfshirë në programin e studimit që po analizojmë, harton një relacion përshkrues për të gjitha aspektet e mësimdhënies duke vënë në dukje problematika të hasura dhe sugjeruar zgjidhje për të ardhmen. Gjithashtu,</p>




eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>institucioni përdor edhe raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC-ja për përditësimin e programit të studimit.</p> <p>Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE.</p> <p>Evidencë-20-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE, 2015.</p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit dhe dokumentacioni përbërës si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit dhe ajo e praktikës mësimore, janë të detajuara por në disa elementë, si në ndarjen në orë në auditor në aktivitete formuese, nuk janë në përputhje mes tyre, apo me aktet ligjore në fuqi.</i></p> <p><i><u>GVJ sugjeron</u> që syllabuset të paraqesin informacion rreth mënyrës së vlerësimit në notë dhe me shkronja sipas sistemit Amerikan, në përputhje me aktet e tjera rregullatore të institucionit, sikurse është rregullorja e njësisë kryesore dhe suplementi i diplomës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi II.4	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për thellimin e njohurive të e studentëve. Personeli akademik është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive praktike studentëve dhe kjo vërehet edhe në takimin me studentët, ku prej tyre u konfirmua impenjimi i stafit akademik në orë praktike si në laborator ashtu edhe në punime individuale të studentëve. Institucioni ka në funksion një sërë marrëveshjes institucionale të cilat janë shfrytëzuar plotësisht në funksion të programit të studimit.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.</p>




<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional.</p> <p>Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit “Gjuhë Angleze” vihet re se ajo përmban lëndë që bëjnë të mundur aftësimin teorik dhe praktik të studentëve duke i përgatitur si specialistë të gjuhës angleze me njohuri rreth gjuhës, kulturës, letërsisë dhe historisë së gjuhës angleze. Lëndët bazë të detyrueshme i ofrojnë studentit njohuri dhe përgatitje metodologjike ndërsa lëndët karakterizuese ofrojnë njohuri të thelluara në fushën e studimit. Komponentët mësimorë të mësimin në auditor (leksione, seminare) nxisin aftësimin praktik dhe përdorimin profesional të gjuhës angleze në specifikat e fushave të përfshira në program. Këto reflektohen në syllabuset lëndore përkatëse. Kontrolli i vazhueshëm, provimi i ndërmjetëm (400 pikë), provimi përfundimtar (500 pikë) dhe detyrat e kursit (100 pikë) sigurojnë vazhdimësi në përgatitjen e studentëve.</p> <p><i>GVJ vëren se vlerësimi i studentëve bëhet vetëm me shkrim dhe se duhet të bëhet një kombinimi i vlerësimit me gojë dhe me shkrim, për vetë specifikën e programit.</i></p> <p>Evidencë-23-Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional "Mësues i Gjuhës Angleze" pas Riorganizimit.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze”, është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme kombëtare/ndërkombëtare dhe në bazë të sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS) me lëndë semestrare, me kredite të njëjta (4 kredite secila lëndë); përjashtim këtu bëjnë lëndët “Teori Përkthimi” dhe “Përkthim/ Interpretim” me nga 5 kredite dhe Teza e diplomës/ Provimi i formimit me 6 kredite. Raporti teorik-praktik është në përputhje me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Evidencë-36-Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe</p>	<p>Në programin e studimit “Gjuhë Angleze”, modulet janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke respektuar dhe legjislacionin në fuqi. Studentët e nivelit bachelor kanë mundësi të transferojnë studimet e tyre në programe të</p>




<p>praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. Në këtë program studimi transferohen studentë nga IAL të tjera publike dhe jopublike ose që e zgjedhin këtë program si program të dytë studimi. Formimi teoriko-praktik mundëson punësim në përfundim të studimeve.</p> <p>Evidencë-36- Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-2- Statuti UAMD, 2018</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, si dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, GVJ evidentoi praktikën e punës së institucionit, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe programit të studimit, diskutohen nevojat për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme brenda normës së lejuar në një vit akademik. Kërkesa për ndryshimet në kurrikulën e programit të studimit parashtrohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë dhe pasi miratohet në departament ndjek procedurat institucionale të miratimit në Senatit akademik dhe më pas në ministrinë përgjegjëse për arsimin. Literatura ofrohet në gjuhën angleze dhe gjendet në bibliotekat online. Sipas RVB kjo literaturë përditësohet në mënyrë të vazhdueshme me botime të 5 viteve të fundit.</p> <p>Nga kontrolli i syllabuseve, u konstatua se literatura në disa raste nuk është e përditësuar. <i>GVJ sugjeron që të përditësohen syllabuset me literaturë të 5 viteve të fundit.</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe në takimin me stafin akademik, pedagogët përgjegjës u shprehën se përditësojnë literaturën plotësuese me pjesë apo publikime të reja për të mundësuar përvetësimin e njohurive.</p> <p>Evidencë-65- Analiza Vjetore e Njësisë Bazë në lidhje me programin Bachelor “Gjuhë Angleze” 2021-2022”.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-37-Ndryshimet në planin Mësimor Gjuhë Angleze.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit “Gjuhë Angleze” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në fushën e gjuhësisë, historisë e kulturës. Struktura e programit, raporti teori praktike, përfshirja e studentëve në kryerjen e detyrave të kursit garantojnë përfundimin e kompetencave të synuara.</p>





	Evidencë-37-Dosja e Plotë e Masterit Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze” pas Riorganizimit.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe/ose punësimin të studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit “Gjuhë Angleze” i nënshtrohet një analize për të parë ecurinë e programit dhe nevojat e studentëve që do të përballen me tregun e punës. Formimi i marrë në këtë program studimi u mundëson atyre vijimin e mëtejshëm të studimeve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Evidencë-31-Studentët e trajnuar nga Zyra e Karrierës.			
Konkluzione	<p><i>Lëndët në program përkojnë me objektivat formuese të tij dhe sigurojnë vazhdimësi si në përgatitjen e studentëve ashtu edhe në një vlerësim më objektiv të tyre.</i></p> <p><i>Vlerësimi i studentëve bëhet vetëm me shkrim. <u>GVJ sugjeron të bëhet një kombinimi i vlerësimit me gojë dhe me shkrim, për vetë specifikën e programit.</u></i></p> <p><i>Nga kontrolli i syllabuseve, GVJ konstaton se literatura në disa raste nuk është e përditësuar. <u>Sugjerojmë të rishikohet literatura në syllabuset e lëndëve duke u përditësuar me literaturë të viteve të fundit. Lidhur me sa më sipër, ky standard përmbushet kryesisht.</u></i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse	Departamenti i Gjuhëve të Huaja synon përmirësimin e vazhdueshëm të programit bazuar në “Planin e Zhvillimit Strategjik” të UAMD. Ky plan synon rritjen e numrit të projekteve me impakt rajonal dhe për komunitetin si dhe rritjen e numrit të veprimtarive të përbashkëta me organizime me Alumnin të cilat ndikojnë komunitetin. Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” ka siguruar dhe garanton pjesëmarrjen dhe angazhimin e studenteve në

<p>konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>panairin e karrierës apo të ndërveprimit praktik me palët e treta si pjesë e transferimit të njohurive si dhe punësimit të tyre.</p> <p>Evidencë-23-Plani Strategjik i Zhvillimit te Programit Gjuhë Angleze Evidencë-27-Shoqata Alumni UAMD. Evidencë-3-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD 2020-2025</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në UAMD, studentët janë të përfaqësuar në organet kolegjiale konform Statutit dhe Rregullores së UAMD. Si edhe u konstatua gjatë takimeve të GVJ, përtej përfaqësimit në këto organe, institucioni përfshin opinionet e studentëve në diskutimet e brendshme të njësive bazë për përmirësimin e vazhduar të programeve që ofrohen. Në nivel universiteti është ngritur dhe funksionon Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, për të ndjekur punësimin e tyre. Orientimi dhe këshillimi i studentëve në lidhje me punësimin bëhet nga kjo zyrë.</p> <p>Evidencë-2- Statuti UAMD, 2018. Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, realizon në mënyrë të përvitshme një analizë në tërësi të aktivitetit të saj, përfshirë edhe atë të nevojave për përmirësim të vazhduar të ofertës së saj didaktike. GVJ konstaton se përmirësimet që prekin programin në ndikimin e informacioneve dhe zhvillimeve të fundit lidhen me: përshtatjen e programeve lëndore, trajnime jashtë kurrikulare, trajnime të personelit akademik në fusha specifike, përmirësimin e infrastrukturës në dispozicion të mësimdhënies dhe praktikave mësimore, zhvillimin e projekteve të përbashkëta apo bashkëpunimeve të ngjashme, ndryshime në kurrikulën e programit të studimit, organizimin e konferencave me departamente të njëjta etj.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Gjuhëve të Huaja analizon dhe merr opinionet e bashkëpunëtorëve si nga tregu i punës ashtu edhe nga ai akademik i institucioneve partnere. Informacioni që vjen nga bashkëpunimi me palët e treta dhe nga analizat për nevojat e tregut shërben për përshtatjen dhe riorganizimin e programit. GVJ e konsideron këtë standard të përmbushur plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion, vërehet se transmetimi i dijeve në auditor realizohet në mënyra të ndryshme. Bazuar në Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” “Për Organizimin e Studimeve”, çdo lëndë mësimore organizohet si ndërthurje e elementëve të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi. Konkretisht në programin Bachelor në “Gjuhë Angleze” orët mësimore ndahen në leksione dhe seminare. Detyrat e kursit të punuara dhe prezantuara në formë eseje ose projekte individuale/në grup kanë një rol të veçantë në vlerësimin përfundimtar. Një rol të rëndësishëm zë edhe Praktika profesionale duke patur parasysh natyrën e kësaj fushe studimi.</p> <p>Evidencë-2- Statuti UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-3-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD 2020-2025.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Neni 40,48 dhe Neni 60.</p> <p>Evidencë-130-Rregullore e Praktikës, 2019.</p> <p>Evidencë-49- Marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Me qëllim që procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies të realizohet në një formë më kuptimplotë e gjithashtu të bëhet tërheqës për studentët, të rrisë angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre, lektorët kanë në dispozicion mjete audio vizuale si laptop-e, video-projektorë, të cilët përdoren nga lektorët dhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup apo ato individuale. Gjatë vizitës në institucion, në takim me studentët e programit bachelor, studentët u shprehën se mënyrat e organizimit të mësimin janë të larmishme, efektive dhe sigurojnë përvetësimin e njohurive dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në mësim.</p>

	<p>Evid. 42. Pyetësor Student UAMD</p> <p>Evid. 43. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni mbështet dhe angazhohet për përparimin akademik të personelit. Një formë e mbështetjes është pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+ për shkëmbim stafi dhe studentësh. Konstatohet se konferencat dhe seminarët shkencorë në partneritet me universitete homologe brenda dhe jashtë vendit i kanë krijuar mundësinë stafit akademik të shkëmbejë përvojë, mendime dhe literaturë në fushat e tyre të ekspertizës.</p> <p>Evidencë-49-Marrëveshjet e bashkëpunimit, Marrëveshjet Kombëtare/Ndërkombëtare - Universiteti "Aleksandër Moisiu" (uamd.edu.al).</p> <p>Evidencë-64-Mobilitetet e Stafit Akademik FE.</p> <p>Evidencë-76-Raport mbi Aktivitetin Kërkimor-Shkencor UAMD, 2018-2019.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është i kualifikuar në fushën e tij/saj të studimit dhe kërkimit. Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, duke u mbështetur nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë.</p> <p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ vëren se personeli akademik përdor metoda interaktive. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj. Studentët e programit shprehen pozitivisht për njohuritë që kanë fituar, për përfshirjen e tyre në jetën e institucionit, për mbështetjen që kanë gjetur në institucion për probleme të ndryshme dhe për trajtimin me respekt nga stafi akademik.</p> <p>Evidencë-46-Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe me Kontratë në Njësinë Bazë, 2022-2023.</p> <p>Evidencë-12-Strategjia e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2020-2025.</p> <p>Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e</p>	<p>GVJ vëren nga shqyrtimi i dokumentacionit se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe</p>

<p>programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Konstatohet se njësia përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies se personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë. Drejtuesi i njësisë bazë analizon në fund të çdo semestri performancën e çdo anëtari të departamentit. UAMD përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi të plotësojnë pyetësorë periodikë për vlerësimin e të gjithë aspekteve akademike dhe administrative të jetës studentore.</p> <p>Evidencë-2- Statuti UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-20-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE, 2015.</p> <p>Evidencë-67-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit.</p> <p>Evidencë-68-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, konstatohet se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport periodik. NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe e vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuara. UAMD është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare. Një nga përfitimet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie.</p> <p>Evidencë-18- Rezultatet mbi Anketimin e Studentëve, Stafit Akademik dhe Administrativ mbi Institucionin.</p> <p>Evidencë-17-Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Evidencë-49- Marrëveshjet Kombëtare/Ndërkombëtare - Universiteti "Aleksandër Moisiu" (uamd.edu.al).</p> <p>Evidencë-12-Strategjia e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2020-2025.</p>




Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht. UAMD ka ngritur mekanizma për monitorimin e brendshëm të cilësisë, mekanizma të cilët përfshijnë edhe studentët si një hallkë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e UAMD, në veçanti neni 68, Kontrolli i Dijeve, Neni 69, Zhvillimi i Provimeve, Neni 70, Rregullat e provimit dhe neni 71, Ankimimi i provimeve.</p> <p>Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim, detyrave të kursit, prezantimeve, praktikave mësimore si dhe tezës së diplomës që paraqitet për mbrojtje në përfundim të mbylljes së të gjitha detyrimeve akademike për programin e studimit Bachelor “Gjuhë Angleze”. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë mësimi të çdo semestri.</p> <p>Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD.</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor “Gjuhë Angleze”.</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja, për programet që mbulon, informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve. Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, bazuar në specifikat e secilës lëndë. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit. Studentët gjejnë informacion edhe në syllabuset e lëndëve, ku në varësi të natyrës së lëndës, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti</p>

<p>syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>aplikativ, përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD 2018.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - provimi i ndërmjetëm (0-400) pikë; - niveli i pjesëmarrjes në seminare, detyra kursi (0-100) pikë; provimi përfundimtar (0-500) pikë; <p><i>GVJ mendon se nisur nga karakteristikat e programit, mund t'i lihet më shumë vend në vlerësim, vlerësimin të aftësive komunikative. Niveli i pjesëmarrjes në seminare dhe/ose detyra e kursit vlerësohen me 0-100 pikë, ndërkohë që dy provimet së bashku me 0-900 pikë.</i></p> <p><i>Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE.</i></p> <p>Evidencë-36-Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dispozicion si dhe në takimet me studentët e këtij programi studimi, vihet re se format dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Vlerësimet bëhen pjesë e analizës në njësinë bazë dhe përdoren për përmirësimin në vazhdim të shërbimeve të ofruara nga njësia bazë dhe ajo kryesore.</p> <p>Evidencë-67-Formulari i Vlerësimin të Programit të Studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në</p>	<p>Studentët motivohen për projekte praktike individuale apo punime në grup, punime të cilat prezantohen përpara pedoagugt të lëndës dhe studentëve të tjerë që frekuentojnë atë lëndë ose në konferenca studentore të realizuara brenda institucionit.</p> <p>Në lidhje me mësimdhënien, pedagogët respektojnë rregullat e institucionit, mbi mënyrën e zhvillimit të orës së mësimin, vlerësimin e studentëve, literaturën dhe materialet që u ofrohen studentëve, etj.</p> <p>Evidencë-95-Vendim Rektorati për marrjen e masave gjatë pandemisë, Vendim për përdorimin e platformave online.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor “Gjuhë Angleze”.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p>




të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.									
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. UAMD ka të hartuar qartë procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron se nisur nga karakteristikat e programit, raporti i vlerësimit të studentit (në këtë program studimi), duhet të rishikohet dhe t'i lihet më shumë vend në vlerësim, vlerësimit të aftësive komunikative.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
			X						

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në Rregulloren e UAMD, në veçanti neni 68, Kontrolli i Dijeve, Neni 69, Zhvillimi i Provimeve, Neni 70, Rregullat e provimit dhe neni 71, Ankimimi i provimeve. Të gjithë këta elementë i bëhen të ditur studentëve prej pedagogëve të lëndëve dhe në syllabuset e përditësuara të lëndëve, në orën e parë të mësimin. Studenti ka të drejtën e hyrjes në provim kur plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret e studimeve dhe i nënshtrohet provimit final.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD 2018.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor “Gjuhë Angleze”.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	<p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, realizohet duke kombinuar metodat tradicionale (provimet me shkrim dhe me gojë) si dhe format elektronike si hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave/projekteve të kursit. Krahas vlerësimit tradicional, Institucioni vë në zbatim sistemin elektronik të testimit dhe</p>

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>vlerësimi, nëpërmjet marrëveshjes së nënshkruar me Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit (AADF) dhe projektin Clean Score.</p> <p>Evidencë-94-Përdorimi i CLEANSCORE në testime.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në takimin me studentët e këtij program studimi, studentët konfirmuan se mënyra e vlerësimit të njohurive u bëhet e ditur nga pedagogu i lëndës në javën e parë të leksioneve. Mënyrat dhe format e vlerësimit janë të paraqitura edhe në syllabusin përkatës të lëndës si dhe në rregulloret institucionale.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të studentëve që realizohet me testim të ndërmjetëm 40% (java e 7 dhe e 8) dhe 50% e vlerësimit në provimin përfundimtar në përfundim të lëndës (java e 15 dhe e 16), si dhe 10% të vlerësimit e zë detyra/projekti i kursit të cilin student e prezanton në javën e 14-të të procesit mësimor. Forma e kontrollit të dijes në UAMD përfshirë dhe programin Bachelor në “Gjuhë Angleze” është me provim me shkrim. Mënyra e vlerësimit është e pasqyruar në syllabusin e çdo kursi në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatore të FE dhe UAMD.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregulloreve në fuqi të institucionit. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen njohuritë dhe puna individuale e studentit. Staf i akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Edhe në korrigjimin e provimeve, ato shoqërohen me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe motivin e vlerësimit.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiature gjatë procesit të provimit. Për këto të fundit, përgjegjësinë kryesore për vlerësimin dhe shmangien e plagjiaturës e ka pedagogu udhëheqës.</p> <p><i>GVJ konstaton se kontrolli i plagjiaturës në punimet e diplomave ose në detyrat e kursit, merret përsipër nga</i></p>




	<p><i>pedagogu dhe është përgjegjësi e tij/saj. Gjatë takimeve me stafin akademik u konstatua se ky kontroll kryhet në mënyra dhe me programe të ndryshme. Institucioni nuk ofron programe të kontrollit antiplagjiaturë, përdorimi i të cilave mund të unifikojë mënyrat e kontrollit dhe gjetjet.</i></p> <p>Evidencë-24-Rregullore e Diplomimit.</p> <p>Evidencë-5-Kodi i Etikës UAMD.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët njihen me mënyrën e vlerësimit si dhe përqindjet përkatëse në fillim të procesit mësimor. Tezat hartohen që të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të modulit dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Gjatë procesit të korigjimit, stafi shënon pikët për çdo ushtrim. Pikëve të provimit të ndërmjetëm dhe detyrës së kursit i shtohen pikët e provimit përfundimtar, të cilat pasi konsultohen me studentet hidhen brenda 72 orëve në sistemin Pitagora, ku edhe llogaritet nota përfundimtare. Vonesa në dhënien e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore konstaton se vlerësimi kryhet me sistem prej 1000 pikësh i përkthyer në bazë notash nga 1 në 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ vë re se vlerësimi i vazhduar hidhet në sistemin Pitagora, së bashku me vlerësimin e provimit final dhe bazuar në rregulloren e studimeve të FE.</p> <p>Referuar takimit me studentet, GVJ konstaton se ata njohin të drejtën e tyre për ankimim, sikurse është e saktësuar edhe në rregulloren e UAMD. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës, të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare. Pas kësaj faze, sërisht studenti ka të drejtën e kontestimit të notës duke paraqitur kërkesë pranë Dekanit të Fakultetit të Edukimit. Kërkesa shqyrtohet dhe nëse pranohet, analizohet nga një komision <i>ad-hoc</i> i ngritur me pedagogë të disiplinës që po vlerësohet. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi, u vë re se studentët në përgjithësi marrin përgjigje rreth çdo paqartësie të mundshme me pedagogët e lëndës, pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.</p>

	Evidencë-4- Rregullore UAMD 2018. Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Të drejtat e studentit janë të përcaktuara në rregulloret institucionale. Në këto rregullore përcaktohen mënyrat se si dhe kur studenti mund të kryejë një ankesë, si shqyrtohet ajo dhe mënyra e informimit. Megjithatë, gjatë vizitës në institucion nuk u vu re një praktikë konkrete, pasi studentët nuk kishin patur ankesa/kërkesa që të kërkonin përshkallëzime përtej njësisë bazë.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se kontrolli i plagjiaturës në punimet e diplomave ose në detyrat e kursit, merret përsipër nga pedagogu dhe është përgjegjësi e tij/saj. Gjatë takimeve me stafin akademik u konstatua se ky kontroll kryhet në mënyra dhe me programe të ndryshme. Sugjerohet që institucioni të ofrojë programe të kontrollit antiplagjiaturë, përdorimi i të cilave mund të unifikojë mënyrat e kontrollit dhe gjetjet. GVJ shprehet se ky standard përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi Bsc “Gjuhë Angleze” synon arsimimin dhe formimin e specialistëve në fushën e gjuhës angleze si dhe synon të krijojë tek studentët aftësi interpretuese, analitike dhe zbatuese të përfuara gjatë periudhës së studimit në këtë program, me impakt në sferën profesionale. Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se ky program studimi synon që studenti të marrë njohuri dhe aftësim profesional me qëllim orientimin e tij praktik në fushën e gjuhës angleze. Evidencë-36-Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.

	Evidencë-13-Rregullore Bachelor "Gjuhë Angleze".
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Programi i studimit "Gjuhë Angleze" është pjesë e programeve të ciklit të parë të studimeve që ofron Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe synon të zhvillojë aftësi në fushën e gjuhës angleze, si ato gjuhësore përmes disiplinave si gramatika, semantika, leksikologjia, hyrja në gjuhësi, etj, letrare përmes disiplinave të letërsisë angleze, letërsisë amerikane. Gjithashtu programi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta si në fushën e teknologjisë, të shkencave të komunikimit, duke përfshirë lëndë dhe veprimtari formuese në këto fusha. Ky program ofrohet në gjuhën angleze, por ka edhe lëndë në gjuhën shqipe.</p> <p>Evidencë-36-Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	<p>Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi përfundimtar dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën përfundimtare të modulit. Në syllabuset e çdo lënde studentët kanë informacion në lidhje me kompetencat, aftësitë dhe rezultatet e të nxënit.</p> <p>Në përfundim të lëndës, pedagogu bën edhe një përmbledhje për efekt orientimi dhe përsëritje të koncepteve/çështjeve kryesore të trajtuara, si dhe orienton studentët për provimin përfundimtar të lëndës. Vlerësimi final përban 60% të materialit të trajtuar në 7 javët e fundit dhe 40% materialit të zhvilluar në shtatë javët e para. Treguesit mund të shprehen edhe në %, sipas rregullores së programit dhe që pasqyrohet edhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD 2018.</p>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për	<p>Stafi akademik organizon diskutime me studentët për temat e diplomës, për mundësitë e punësimit të tyre, u prezanton pjesëmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume etj.</p> <p>Lëndët janë të ndërtuara në bazë të kërkesave të tregut të punës, të përkthyer në nivel kompetencash për secilën lëndë. Studentit i krijohet mundësia të zbatojë këto kompetenca gjatë orëve të seminareve dhe praktikës profesionale, e cila i jep mundësinë studentëve për të zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë. Praktika profesionale zhvillohet në institucione sipas profilit të përgatitjes së studentit në një nga institucionet me të cilat UAMD/FE/DGJH ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>

zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Evidencë-78-Baza e Kërkimit Shkencor në Njësinë Bazë. Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018. Evidencë-117-Ndarja e praktikës në Departament 2021-2022. Evidencë-118-Dosja e plotë e praktikave për programin Bachelor Gjuhë Angleze.			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Përgjatë vitit akademik, njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët e saj. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Evidencë-66-Lista e Leksioneve të Hapura 2021-2022.			
Konkluzione	<i>Njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi të ofertës akademike duke realizuar në mënyrë të vazhduar takime, seminare, ëorkshop-e, në kuadër të bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës. Ky program është plotësisht në funksion të qëllimit për të cilin është hartuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i	Institucioni parashikon procesin e diplomimit të studentëve në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e FE dhe ajo e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, paraqesin procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi. Procedura më specifike për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës, gjenden në rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”.

<p>jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës caktohen nga Përgjegjësi i njësisë bazë dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit në bashkëpunim me anëtarët plotësojnë një program tematikash për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, si dhe për tematikat e zhvillimit të punimeve të diplomave, hartohen nga stafi i brendshëm akademik dhe vihen në dispozicion të studentëve. Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor “Gjuhë Angleze”.</p> <p>Evidencë-120-Kërkesë për Provim Formimi.</p> <p>Evidencë-32-Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi.</p> <p>Evidencë-121-Manual për punimin e diplomës bachelor Fakulteti i Edukimit UAMD.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Përgjegjëse për mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik, përfshirë edhe diplomimin e studentëve, është njësi bazë. Kjo njësi harton, në bashkëpunim me të gjithë stafin akademik, një fond pyetjesh orientuese për studentët dhe për përgatitjen e tyre për provimin përfundimtar. Për studentët që dëshirojnë të diplomohen duke mbrojtur një punim diplome, caktohet një pedagog si udhëheqës i cili ka rol kyc në vlerësimin cilësor të punimit të studentit dhe në udhëqjen e tij.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-32-Formulari i Kërkesës për Tezën e Diplomës dhe Vlerësimi.</p> <p>Evidencë-44-Udhëheqjet e Temave të Diplomave, Bachelor Gjuhë Angleze 2021-2022.</p> <p>Evidencë-121-Manual për punimin e diplomës bachelor Fakulteti i Edukimit UAMD.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të</p>	<p>GVJ konstaton se teza e provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i provimit përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtarë bazuar në pyetjet e</p>




rëndësisë dhe peshës specifike.	paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar. Evidencë-7-Rregullore FE, 2019. Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve me GVJ, personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e temës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik. Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së punimit përpara komisionit, mbasi është marrë miratimi i udhëheqësit i cili ka rojl këshillues/udhëzues për studentin në realizimin e punimit të diplomës. Evidencë-121-Manual për punimin e diplomes bachelor Fakulteti i Edukimit UAMD. Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni vendos në dispozicion të studentëve fondin e bibliotekës së UAMD. Për përgatitjen e temës së diplomës, institucioni vendos në dispozicion të studentëve në tërësi, edhe fondin e bibliotekës fizike, dhe bazuar edhe në programet e ndryshme të studimit që ofrohen, kanë vlerësuar mbajtjen e bibliotekës hapur edhe në fundjavë për ta bërë atë të aksesueshme maksimalisht për studentët. Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Punimi i diplomës ose provimi përfundimtar, në planin mësimor është përcaktuar me 6 kredite ECTS dhe vlerësohet me notë, njësoj si çdo lëndë tjetër e këtij programi studimi. Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të	Bazuar në dokumentacionin e DVV, institucioni ka të miratuar modelin e diplomës nga QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore). Së bashku me diplomën, studenti pajiset edhe me suplementin e saj. Si procedurë standarde, institucioni harton diplomat për studentët e diplomuar, dy herë në vit, në sezonin e dimrit dhe në atë të vjeshtës. Në sekretarinë mësimore dhe në njësinë kryesore, ruhet i gjithë dokumentacioni për çdo vit




studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>akademik, dhe studenti, edhe mbasi është diplomuar, mund të kërkojë kopje të dokumentacionit.</p> <p>Evidencë-39-Suplementi Bachelor Gjuhe angleze.</p> <p>Evidencë-38-Model Diplome, i Miratuar nga MASR, 2019.</p> <p>Evidencë-2-Statuti UAMD, 2018.</p>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstatohet se dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, vihet re një organizim i mirë i arkivës dhe i materialeve për çdo student, lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë.</p> <p>Evidencë-83-Rregullore e Bibliotekës.</p> <p>Evidencë-98-Rregullorja për Arshivimin e Dokumentacionit.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.</p>			
Konkluzione	<p><i>UAMD ka të përcaktuar qartë procedurat e përfundimit të studimeve, mbrojtjes së diplomës dhe të provimit të formimit.</i></p> <p><i>UAMD pajis studentët me diplomë sipas standardit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, së bashku me suplementin e saj. Procedura e mbrojtjes së diplomës përcaktohet nga rregullorja përkatëse.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1




Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret **Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Për të mbuluar lëndët mësimore të programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është angazhuar staf akademik me përgatitje specifike në atë fushë. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar për periudhën 2020-2022 është si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 19 PAE dhe 1 PAK (95 % /5 %);
2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 21 pedagogë nga të cilët 18 PAE dhe 3 PAK (85 % /15 %);
3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 18 PAE dhe 2 PAK (90 % / 10 %);

Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-
Prof.As.Dr	2	-	4	-	2	-
Dr/PhD	16	-	13	-	14	-
Msc	1	1	1	3	2	2
Në total	19	1	18	3	18	2

Gjatë vizitës në institucion dhe bisedës me pedagogë u theksua nga pedagogët e rinj se janë të mbështetur nga pedagogët me përvojë më të gjatë. Gjithashtu ata theksuan se organizimi i leksioneve të hapura është një formë e mirë për të përhapur përvojën më të mirë dhe për të shkëmbyer mendime me kolegë.

Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.

Evidencë 154 tab 6.1-6.3

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të

Nga analiza e ngarkesës mësimore rezulton se rreth 94% e ngarkesës mësimore mbulohet nga Personeli Akademik




<p>mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Efektiv(PAE) në UAMD. Për lëndët karakterizuese të këtij programi studimi, angazhohet staf akademik me përvojë dhe me kualifikimet e duhura.</p> <p>Ngarkesa e personelit akademik, është përcaktuar në respekt të lirisë akademike dhe në përputhje me ekspertizën përkatëse të stafit akademik. Departamenti i Gjuhëve të Huaja planifikon çdo vit ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik, mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet cilësore të UAMD. Ngarkesa mësimore e personelit akademik është me përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe bazohet në grupet lëndore ku bëjnë pjesë si dhe përvojës që kanë fituar. Ngarkesa e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Evidencë-43- Ngarkesa Mësimore e Personelit Akademik në të Gjitha Programet, 2021-2022.</p> <p>Evidencë-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt. 22.07.2015.</p> <p>Evidencë-47-Mbi Ngarkesën Mësimore.MASR(Udhëzim nr.29. dt.-10.9.2018.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Çdo anëtar i personelit akademik me kohë të plotë në Departamentin e Gjuhëve të Huaja / Fakulteti i Edukimit, ka një kontratë pune me afat të pacaktuar për kategorinë lektor dhe profesor dhe me afat të caktuar për kategorinë asistent lektor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe statutit të IAL. Për rinovimin e kontratave me kohë të caktuar, nevojitet rekomandimi i përgjegjës të njësisë bazë (DGJH) dhe dekanit të fakultetit (FE) për performancën e personelit akademik. UAMD mbulon të gjitha detyrimet financiare si sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p>Evidencë-46-Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe me Kontratë në Njësinë Bazë, 2022-2023.</p> <p>Evidencë-43- Ngarkesa Mësimore e Personelit Akademik në të Gjitha Programet, 2021-2022.</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik në FE/UAMD realizohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi, me rregulloren dhe statutin e institucionit. Bazuar në Rregulloren për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, IAL garanton cilësinë e personelit akademik dhe zbaton procedura të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e personelit akademik. Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike është përgjegjëse për dokumentacionin për konkurset për marrjen dhe pranimin e punonjësve në punë, plotësimin e tyre me librezat e punës si dhe për plotësimin e dosjes personale me dokumentacionin e nevojshëm për çdo punonjës të institucionit. Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurim, përmes thirrjeve të hapura. Shpallja e thirrjeve bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike e UAMD, në APP dhe online përmes [https://uamd.edu.al/mundësi-punësimi/] sipas kritereve të përcaktuara nga Njësia Bazë.</p> <p>Per vlerësimin e dosjeve të kandidatëve Njësia Kryesore ngrë një komision ad-hoc i cili vlerëson kandidatët në dy faza: përmes vlerësimit të dosjes dhe përmes intervistës. Për pikëzimin e kandidatëve sipas kritereve të përgjithshme dhe specifike, UAMD përdor formularë aplikimi të unifikuar në nivel institucional ndërsa vlerësimi i kandidateve bëhet sipas Çelësit të vlerësimit të paketës së aplikimit. Institucioni ka paraqitur evidencë në lidhje me procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit të stafit akademik. Procedura që ndjek UAMD është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Zyra e burimeve njerëzore UAMD mban dhe ruan një bazë të plotë dhe të qartë të raporteve të rekrutimit të stafit akademik, njoftimeve për punë, konkurseve, etj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit Bachelor “Gjuhë Angleze”, pasi në kurrikulën e këtij programi studimi nuk parashikohet zhvillimi i orëve laboratorike.</p> <p>Evidencë-17-Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Evidencë-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Evidencë-60-Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt. 22.07.2015.</p> <p>Evidencë-114-Procedurë Rekrutimi.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018.</p>




<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Evidencë-36-Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesen e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Gjatë këtij takimi dhe në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi, që përfshin: diplomat, çertifikat e ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, librezën shëndetësore, kërkesën e punësimit etj.</p> <p>Të dhënat e stafit efektiv dhe me atij me kontratë administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në nivel institucional dhe nga njësia kryesore dhe njësitë bazë për program studimi. Informacioni administrohet duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale dhe arkivohet konform akteve rregullatore institucionale. Në përfundim të vitit akademik, nga Njësia Bazë administrohen edhe evidencat e detajuara për plotësimin e orëve mësimore. Konfidencialiteti i të dhënave personale sanksionohet edhe në nenin 7 të Kodit të Etikës së UAMD. GVJ përmes dokumentacionit të paraqitur nga UAMD dhe takimeve të zhvilluara konstaton korrektësinë në zbatimin e procedurës së administrimit të të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës-akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Evidencë-25- Rregullore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-5-Kodi i Etikës UAMD.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore, Bachelor Gjuhë Angleze.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>Bashkëpunimet e UAMD me industrinë, biznesin, dhe institucione të tjera të arsimit të lartë mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara. Gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi investime të arritura falë bashkëpunimeve me biznesin dhe/ose pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo infrastrukturë vihet në dispozicion të studentëve për realizimin e temës së diplomës dhe/ose veprimtari të tjera specifike sipas programeve të lëndëve. IAL ofron trajnime/ëorkshope profesionale që mbështeten nga bizneset partnere.</p> <p>Evidencë-61-Kodi i Cilësisë.</p> <p>Evidencë-63-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR.</p> <p>Evidencë-64-Mobilitetet e Stafit Akademik FE.</p>

profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.									
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Referuar RVB dhe dokumentave të dorëzuar, konstatohet se studentët ndihmohen nga lektorët udhëheqës gjatë zhvillimit të praktikës profesionale dhe periudhës së vëzhgimit në shkolla. Vlerësimi përfundimtar i praktikës është rezultat i vlerësimit të vazhdueshëm të mësuesit mentor dhe lektorit udhëheqës . Studenti duhet të plotësojë një dosje që përmban një ese (rreth përvojës së tij për teknikat e mësimdhënies, përshtypjet e studentit praktikant mbi praktikën në tërësi, mbi motivimin e mësuesit dhe të nxënësit dhe të disiplinës në klasë) si dhe dhjetë ditare nga orët e vëzhguara dhe të zhvilluara. Në këtë proces studentit ndihmohet nga lektori në takimet e tyre të përjavshme. Evidencë-118-Dosja e plotë e Praktikave për Programin Bachelor Gjuhë Angleze.								
Konkluzione	<i>Programi Bachelor në Gjuhë Angleze mbulohet nga staf akademik me përgatitje specifike në fushë, i cili mban kryesisht gradën shkencore Doktor. Procedura që ndjek UAMD për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit për pozicionin e punës. IAL dëshmon qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv.</i> <i>GVJ vlerëson pozitivisht investimet në laboratorë të arritura falë bashkëpunimeve me biznesin dhe/ose pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të	Procesi mësimor në programin e studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” zhvillohet në Kampusin e ri universitar, Spitallë Durrës. UAMD ka mjediset të përshtatshme si: zyra, bibliotekë,

<p>përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>sallë konferencash etj. Konstatohet se disa nga sallat mësimore janë të pajisura me mjete teknologjike audiovizive, lidhje interneti etj për tu përdorur nga stafi akademik dhe studentët gjatë procesit mësimor</p> <p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike brenda auditorëve. DGJH ka në përdorim edhe dy klasa laboratorike të përshtatshme për zhvillimin e mësimin. Instalimi, mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet një laborant i dedikuar për mirëmbajtjen teknike të secilit laborator. Sallat e leksioneve dhe lëndëve teorike janë të pajisura me sistem kondicionimi, LED screen 65” ose projektore HD. GVJ gjatë vizitës në institucion vizitoi mjediset ku zhvillon mësimin programi Bachelor në “Gjuhë Angleze” dhe konstaton që godina e FE është funksionale për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor, por është domosdoshmëri të bëhet një pajisje më e mirë e klasave me mjete audiovizuale.</p> <p>Evidencë-71-Infrastruktura në Funksion të Programit të Studimit.</p> <p>Evidencë-72-VKM nr.418, “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin e Programeve, dt. 10.5.2017.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që mjediset ku zhvillon mësim FE janë të pajisura me mjete elektronike që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies. Sallat e leksioneve dhe lëndëve teorike janë të pajisura me sistem kondicionimi, ose projektore HD, internet, kompjutera, laptop, etj.</p> <p>Në kuadër të mësimdhënies, në ndihmë të stafit akademik, për një vlerësim sa më transparent dhe të shpejtë të studentëve vjen edhe programi Cleanscore dhe sistemi Pitagora.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë</p>	<p>UAMD vë në dispozicion salla me hapësirë dhe me kushte të favorshme dhe mjete audiovizive për të lehtësuar integrimin e teorisë me praktikën. Si rrjedhojë e kushteve të ofruara studentët mund të fitojnë shprehitë praktike dhe të konsolidojnë njohuritë teorike të fituara gjatë procesit.</p>




<p>aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët mbështesin lëndët përkatëse të cilat mbulojnë nga stafi akademik i departamenteve në FE. Secili laborator është i pajisur me 20-30 PC me parametra të përshtatshëm për të instaluar programet e nevojshme që nevojiten në këtë program studimi.</p> <p>Evidencë-72-VKM nr.418, “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin e Programeve, dt. 10.5.2017.</p> <p>Evidencë-71-Infrastruktura në Funkcion të Programit të Studimit.</p> <p>Evidencë-63-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja, ka në përdorim të tij një laborator ku realizohen aftësitë e të dëgjuarit e të folurit. Ky laborator i vjen në ndihmë procesit mësimor. Në bazë të specifikës së programeve të studimit që ofron FE-UAMD, laboratorët që vihen në shërbim të studentëve janë të pajisur me pajisje profesionale dhe mbështesin studentët në aftësimin e tyre praktik.</p> <p>Evidencë-71-Infrastruktura në Funkcion të Programit të Studimit.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor të programit të studimit dhe për formimin praktik. Departamenti i Gjuhëve të Huaja, në përputhje me fushën e studimeve që ofron dhe natyrën e programit pranë tij ka në dispozicion një laborator ku realizohen aftësitë e të dëgjuarit e të folurit. Për këto arsye standardi përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të</p>	<p>Literatura e bazë e kurseve ofrohet në gjuhën e programit të studimit (anglisht). Në rastin kur nuk ka një botim me ISBN në gjuhën angleze, si litaraturë bazë shërben një cikël leksionesh nga titullari dhe lektorët e lëndës i miratuar në departament.</p>




<p>studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë është e evidentuar qartë në syllabusin e lëndës dhe i vihet në dispozicion studentëve në format elektronik nga pedagogu i lëndës dhe/ose në format fizik në bibliotekën e UAMD. Literatura ndihmëse është kryesisht në gjuhën e studimit (anglisht). Aktualisht në UAMD janë funksionale 3 biblioteka. Koleksioni i tyre përfshin burime që plotësojnë pjesërisht nevojat e përdoruesve. Pasurimi i koleksioneve me botime kryhet edhe nëpërmjet projektit Tempus. Nga takimet me stafin akademik dhe GVB u konstatua se çdo vit akademik departamenti shprehet në lidhje me pasurimin e literaturës shkencore me tituj të rinj.</p> <p><i>GVJ konstaton që shpesh literatura e rekomanduar nuk është e viteve të fundit dhe sugjeron që t'i kushtohet më shumë kujdes përzgjedhjes së literaturës ndihmëse me autorët më të spikatur të fushave përkatëse dhe kjo literaturë të përfshihet edhe në fondin e bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse për lëndët bëhet cdo fillim simestri sipas përcaktimeve në nenin 45 të rregullores së fakultetit për përditësimin e syllabuseve të lëndëve. Njësia përgjegjëse, ruan përditësimet e literatures që përfshihen në kopjet e syllabuseve për çdo semestër.</p> <p>Evidencë-87-Të Dhëna për Bibliotekën.</p> <p>Evidencë-89-Plani-Strategjik i Bibliotekë UAMD, 2015-2020.</p> <p>Evidencë-111-Syllabuset e Lëndëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UAMD vë në dispozicion të studentëve dhe personelit Bibliotekën Shkencore, e cila gjendet në mjediset e Universitetit dhe operon në të tri godinat e UAMD. Biblioteka ka në fondin e saj rreth 12000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit.</p> <p>Biblioteka në Kampusin universitar, përmban rreth 8000 tituj ne gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik si dhe kryen dixhitalizimin e skedarëve. Gjatë vizitës GVJ konstatoi se Biblioteka UAMD bashkëpunon dhe përfiton publikime nga instituti UNRISD, në Zvicër. Në këtë bibliotekë ofrohen mundësi kërkimi të informacionit online, në sallën e leximit, mundësi përdorimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit.</p>




	<p>Evidencë-85-Biblioteka Online, Të Dhëna mbi Materialet e Disponueshme.</p> <p>Evidencë-89-Plani-Strategjik i Bibliotekë UAMD, 2015-2020.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka universitare ofron literaturë, tekste mësimore dhe plotësuese që mbështesin kurrikulat mësimore. Numri i kopjeve për çdo titull varion nga 2-5 kopje mesatarisht, ndërsa kopjet e librit të huaj variojnë nga 1- 2 kopje. Krahas librit fizik, ekziston edhe libri elektronik, (mbi 10000 tituj). Biblioteka universitare është hibride dhe me fonde të hapura. Koleksioni përfshin burime që <i>pjesërisht</i> plotësojnë nevojat e përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma. GVJ konstaton që vitet e fundit biblioteka nuk është pasuruar me fond shtesë të literaturës fizike, por vetëm me fond elektronik (JSTOR, EBSCO, COBISS).</p> <p>Përdorimi aktual fizik i bibliotekës, mbas periudhës së pandemisë është zvogëluar ndjeshëm, pasi studentët preferojnë literaturën elektronike kundrejt asaj fizike.</p> <p><i>GVJ konstaton se ndërsa ka abonime në biblioteka online dhe secili pedagog dhe student ka llogari dhe mund të shfrytëzojë burimet e pasura, <u>mungon</u> fondi fizik për lëndët e kësaj kurrikule. Institucioni duhet të sigurojë fonde për blerjen e titujve për këtë program studimi.</i></p> <p>Evidencë-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.</p> <p>Evidencë-83-Rregullore e Bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët dhe stafi i UAMD kanë akses në bibliotekën e UAMD. GVJ vlerëson pozitivisht krijimin e një databaze elektronike nga biblioteka e UAMD-së që ndihmon komunitetin e UAMD-së të gjejë libra online, të shkarkojë falas artikuj shkencorë, libra elektronike, disertacione, etj. Biblioteka e UAMD është pjesë e bibliotekës virtuale COBISS+. Biblioteka plotëson një pjesë të nevojave të studentëve për literaturë bazë dhe ndihmëse si dhe ofron edhe shërbimin online. Ky shërbim është i barabartë për të gjithë studentët apo personelin. Çdo student apo pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Ata disponojnë një kartelë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajisen me librezë anëtarësimi.</p>
	<p>Evidencë-84-Biblioteka Online-Manual Përdorimi.</p> <p>Evidencë-83-Rregullore e Bibliotekës.</p> <p>Plani-Strategjik i Bibliotekë UAMD, 2015-2020.</p>




<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Mjediset e bibliotekës ofrojnë PC, që kanë të instaluar programe të përshtatshme sipas profilit të studimit duke u mundësuar studentëve leximin, studimin dhe realizimin e detyrave të kursit. Me shfrytëzimin e sistemeve me bazë “kod të hapur”, mbështetur në udhëzimet e BE-së, Nenit 179 të Traktatit të Lisbonës mbi burimet e hapura (open access), me mbështetjen e IFLA-s, biblioteka e Universitetit ka instaluar falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Pas vizitës në mjediset e bibliotekës, GVJ konstaton se në bibliotekë ofrohet një mjedis i sigurtë, me hapësira të rehatshme, që mundëson të mësuarit, kërkimin dhe kreativitetin.</p> <p>Evidencë-89-Plani-Strategjik i Bibliotekë UAMD, 2015-2020.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UAMD funksionon në orarin 8.00-16.00 nga e hëna në të dielë. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në faqen ueb të universitetit.</p> <p>Në përgjigje të nevojave të programeve të studimit, infrastruktura e bibliotekës vendoset në dispozicion të studenteve edhe jashtë orarit zyrtar të punës si dhe në fundjavë (kryesisht për studentët e programeve Master). Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor në përgjigje edhe të nevojave dhe numrit të studentëve.</p> <p>Evidencë-83-Rregullore e Bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë</p>	<p>Sipas RVB, biblioteka në bashkëpunim me fakultetet dorëzon pranë drejtorisë së menaxhimit financiar kërkesat për blerje librash, materiale, pajisje, raftë, skanera, kompjutera, etj.</p> <p>Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore. Biblioteka dorëzon pranë drejtorisë së menaxhimit financiar kërkesat për blerje librash, materiale, skanera kompjuterë, etj. Kjo kërkesë bazohet në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 4 dhe neni 7, Kreu I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.</p> <p>Megjithatë, bazuar në vizitën në institucion, GVJ konstaton që pasurimi i bibliotekës nuk është periodik, por varet nga mundësitë buxhetore të UAMD dhe kryhet nëpërmjet: blerjeve, dhurimeve, shkëmbimit të materialeve mes bibliotekave, artikujve shkencorë, tezave dhe disertacioneve.</p> <p><i>GVJ sugjeron forcimin e rolit të bibliotekës së UAMD dhe pasurimin e saj me më shumë libra fizik të viteve të fundit, në</i></p>



kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<p><i>gjuhën angleze por edhe në gjuhë të tjera. Gjithashtu rekomandohet pasurimi i bibliotekës me fjalorë për përdorim brenda mjediseve të bibliotekës.</i></p> <p><i>Evidencë-83-Rregullore e Bibliotekës</i></p>											
Konkluzione	<p><i>DGJH në realizimin e këtij programi vë në dispozicion të studentëve bibliotekat e institucionit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton që pasurimi i bibliotekës fizike nuk është periodik dhe vitet e fundit nuk ka patur fond librash shtesë, prandaj sugjeron që IAL t'i kushtojë vëmendje të veçantë alokimit të zërit të buxhetit që shkon për pasurimin e fondit të bibliotekës. Institucioni duhet të sigurojë fonde për blerjen e titujve për këtë program studimi.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron forcimin e rolit të bibliotekës së UAMD dhe pasurimin e saj me më shumë libra fizik të viteve të fundit, në gjuhën angleze por edhe në gjuhë të tjera. Gjithashtu rekomandohet pasurimi i bibliotekës me fjalorë për përdorim brenda mjediseve të bibliotekës.</i></p> <p><i>Mbështetur në sa më sipër kriteri përmbushet kryesisht.</i></p>											
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X				
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht									
		X										

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, GVJ konstatoi që Fakulteti i Edukimit në UAMD ka në përdorim programin informatik të menaxhimit të të dhënave Pitagora të zhvilluar dhe administruar nga RASH i cili aksesohet online në https://uamd.pitagora.rash.al/login.</p> <p>Sistemi Pitagora është në ndihmë të institucionit për administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p>Pasi kandidati fiton statusin e studentit, regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm si edhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga MASR dhe më pas pajiset me një ID me anë të të cilës identifikohet dhe logohet në sistemin Pitagora.</p>




	<p>Funksionalitetet kryesore të sistemit të menaxhimit për studentet janë: vlerësimet e vazhduara, mungesat, provimet, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve, mbartja e krediteve të fituara, etj. Në sekretarinë mësimore gjenden: Regjistri i arritjeve akademike të studentit, që vërteton arritjet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik dhe Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave që vërteton emetimin e çertifikatave dhe diplomave.</p> <p>Evidencë-91-Manuali i Përdorimit të Pedagogut PITAGORA</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit Pitagora përdoret nga studentët, pedagogët, financa dhe sekretaria respektivisht sipas roleve që ato kanë në institucion.</p> <p>Çdo përdorues/rol në sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FE/UAMD:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. - Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj. - Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. - Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera. <p>Evidencë-8-Struktura UAMD, 2019.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përdoruesve, të cilët pasi logohen me anë të emailit dhe fjalëkalimit kanë akses në të dhënat e tyre sipas rolit që kanë në institucion. Në këtë mënyrë administrohen të dhënat e studentëve dhe i ofrohet atyre një hapësirë private për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Në këtë mënyrë garantohet privatësia e të dhënave personale dhe liria akademike sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat dhe informacionet janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtari të personelit të FE.</p>




	<p>Të dhënat janë të ruajtura dhe mund të aksesohen për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e FE.</p> <p>Evidencë-90-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>Studentët njihen me vlerësimet përkatëse të cilat përditësohen nga stafi akademik dhe aksesohen nga studentët nëpërmjet sistemit. GVJ vlerëson edhe format e tjera të komunikimit interaktiv (rrjete sociale dhe email) që institucioni përdor për t'iu përgjigjuar studentëve dhe për të arritur një komunikim sa më të shpejtë me ta. Kjo edhe në kuadër të mënyrave të komunikimit të përdorur nga gjeneratat e reja që janë kontigjent i studentëve në këtë program studimi. Stafi akademik angazhohet për një komunikim interaktiv me studentët përmes përdorimit të folderave të përbashkët si Google Drive, Google Classroom, Zoom apo përdorimi i adresave email..</p> <p><i>GVJ konstaton se stafi akademik përdor adresa personale për të komunikuar me studentët nëpërmjet postës elektronike. Po ashtu, në syllabuset e lëndëve, vërehen adresa të postës elektronike të cilat nuk janë ofruar nga institucione adresave institucionale të postës elektronike për komunikim midis stafit dhe komunikim midis stafit dhe studentëve.</i></p> <p>Evidencë-91- Manuali i Përdorimit të Pedagogut PITAGORA.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime sipas roleve të përdoruesve në institucion. Në mënyrë automatike dhe të parametrizuar sistemi i menaxhimit gjeneron raportime në lidhje me kalueshmërinë, notën mesatare, përdorimin e ambienteve didaktike, etj</p> <p>Evidencë-124-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022</p> <p>https://rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra</p>	<p>Në faqen zyrtare të UAMD [https://uamd.edu.al] merret informacion në gjuhën shqip dhe anglisht. Fakulteti i Edukimit ka një sesion të dedikuar në faqen e UAMD nga i cili mund të arrihet në departamentet e këtij fakultetit, programet e studimit që ofron secili departament dhe kurrikulat e tyre, personelin akademik, aktivitete akademike dhe shkencore, revistën shkencore etj. Përtej faqes ueb uamd.edu.al, UAMD përdor</p>




<p>prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>edhe rrjete sociale si Facebook, Instagram dhe LinkedIn ku publikon njoftime dhe foto të aktiviteteve, mundësi praktikash mësimore, bashkëpunime, mobilitete, etj.</p> <p>Evidencë-99-Të Dhëna nga Website-i i UAMD-së: http://www.uamd.edu.al/.</p> <p>Evidencë-100- Thirrje të publikuara në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p>Evidencë-101-Të Dhëna nga Facebook-u i FE-së.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se stafi akademik përdor adresa personale në ofruet shërbimi si google, yahoo, Hotmail etj. për të komunikuar me studentët nëpërmjet postës elektronike. Po ashtu, në syllabuset e lëndëve, vërehen adresa të postës elektronike të cilat nuk janë ofruar nga institucioni.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron përdorimin e adresave institucionale të postës elektronike për komunikim midis stafit dhe komunikim midis stafit dhe studentëve. Ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për</p>	<p>GVJ vëren se UAMD ka raporte financiare që hartohen në nivel institucional. Duke iu referuar Statutit të institucionit, UAMD financohet nga: buxheti i shtetit, pagesat e studentëve, të ardhurat për shërbimet e kryera, të ardhurat nga marrëdhëniet me pale të treta, donacione dhe burime të tjera financimi, veprimtari kërkimore-shkencore, projekte kombëtare ose ndërkombëtare.</p>




<p>të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Bazuar në statut, UAMD financohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Buxheti i shtetit; - pagesat e studentëve për arsimim; - të ardhurat për shërbimet e kryera; -të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të treta; -donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; -veprimtari kërkimore-shkencore; -projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare. <p>UAMD harton një plan buxhetor afatmesëm i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit i cili përditësohet çdo vit. Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Koordinimi i propozimeve të njësisë kryesore realizohet fillimisht nga Senati Akademik i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe harton planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim Bordit të administrimit. Plani financiar paraqet kostot për të gjithë zërat në shërbim të realizimit të programit, duke përfshirë këtu shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, shpenzimet për bibliotekën, kualifikimin e stafit akademik nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikimeve brenda dhe jashtë vendit; etj.</p> <p>Evidencë-3-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD 2020-2025</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Koordinimi i propozimeve të njësisë kryesore realizohet fillimisht nga Senati Akademik i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe harton planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim Bordit të administrimit.</p>
	<p>Buxheti i programit të studimit bachelor në “Gjuhë Angleze” i ofruar nga një institucion publik i arsimit të lartë, i nënshtrohet auditeve të brendshme dhe auditeve nga KLSH sipas legjisllacionit në fuqi. Jane tri burimet potenciale të financimit: Financim nga buxheti i shtetit, financim nga tarifat e</p>

	<p>studentëve si edhe financim nga shërbimet që UAMD ofron për aktorë të tretë. Pasqyra financiare e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe nga burimet e tjera të financimit bëhet publike në faqen ueb të UAMD.</p> <p>Evidencë-6-Raporti Vjetor UAMD, 2018-2019.</p> <p>Evidencë-99-Të Dhëna nga Ëëbsite-i i UAMD-së: http://ëëë.uamd.edu.al/.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVI vëren se UAMD ndjek politika për programin e transparencës me qëllim rritjen e saj në UAMD. Në faqen web të UAMD ka një sesion të dedikuar për transparencën, por për <i>sa i përket plan-buxhetit, realizimit të buxhetit dhe pasqyrave financiare informacioni mungon ose është i papërditësuar.</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik, u vu re se kishte personel akademik të cilët ishin të informuar rreth mundësive të mbështetjes financiare institucionale për avancimin e tyre akademik, si mbështetje për pjesëmarrje në konferenca apo për botime në revista. Edhe pse nga organet drejtuese u bë e ditur, se ky informacion është i plotë dhe transparent duke ju vënë në dispozicion të gjithë stafit akademik, gjykojmë se institucioni duhet të përdori forma më të drejtëpërdrejta dhe transparente për informimni e stafit rreth mundësive financiare të mbështetjes së tyre. Si dhe të parashikojë kriteret për aksesin në këto fonde në mënyrë transparente për të gjithë stafin e kësaj njësie kryesore.</p> <p><i>Sugjerohet që institucioni të realizojë komunikim periodik mbi parashikimet e miratuara të buxhetit afat shkurtër, kriteret dhe përzgjedhjen e shpërndarjes së fondeve të dedikuara për kërkimin shkencor. Ky komunikim të realizohet me mjete transparente jo vetëm në mbledhje të njësisë bazë por edhe me komunikime me postë elektronike (mailing list) të të gjithë stafit.</i></p> <p>Evidencë-103-Raporti i Veprimtarisë Audituese.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit</p>	<p>Drejtoria e Administrimi Financiar ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UAMD-së.</p> <p>Te ardhurat e UAMD-se kanë pësuar rritje të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Në tabelën e mëposhtme paraqitet sasia totale e burimeve të financimit të buxhetit të UAMD në 3 vitet e fundit.</p> <table border="1" data-bbox="595 1883 1367 1939"> <tr> <td></td> <td>2020</td> <td>2021</td> <td>2022</td> </tr> </table>		2020	2021	2022
	2020	2021	2022		




të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Të ardhura dhe financime të ndryshme në 3 vitet e fundit ne Lekë	1,082,354,067	1,076,144,918	1,133,710,586
	<p>Në të ardhurat që vetë UAMD gjeneron, rreth 20% burojnë nga tarifa e shkollimit. Dokumentacioni dhe takimet e kryera garantojnë stabilitetin financiar të këtij programi studimi. Mbështetur në raportet financiare vjetore dhe në analizën e menaxhimit të riskut, institucioni ka kapacitet të sigurojë qëndrueshmëri financiare të programit të studimit si dhe merr në konsideratë analizat për mjaftueshmërinë e kapaciteteve financiare për përmirësimin e situatës financiare në të ardhmen.</p> <p>Evidencë-103-Raporti i Veprimtarisë Audituese.</p>			

Konkluzione	<p><i>UAMD si institucion publik i arsimit të lartë, garanton financim dhe mbështetje financiare nga buxheti i shtetit dhe mbështetje alternative nga burime të tjera. Të ardhurat financiare në tërësi kanë pësuar rritje gjatë viteve të fundit.</i></p> <p><i>GVJ vëren se UAMD ndjek politika për programin e transparencës me qëllim rritjen e saj në UAMD. Në faqen ueb të UAMD ka një sesion të dedikuar për transparencën, por për sa i përket plan-buxhetit, realizimit të buxhetit dhe pasqyrave financiare informacioni mungon ose është i papërditësuar.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron më tepër vëmendje në përfshirjen e të gjithë aktorëve të IAL deri në nivel departamenti në procedurën e parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe kriterëve për akses në fondet e brendshme të kërkimit shkencor, përfshirë edhe mbështjen për pjesëmarrje në konferenca apo për botime shkencore. GVJ vlerëson këtë standard si të përmbushur plotësisht.</i></p>			
--------------------	---	--	--	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se institucioni ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen për pranimin e studentëve në programin Bachelor në “Gjuhë Angleze”. Në aktet rregullatore: Statuti i UAMD-së, Rregullorja e Fakultetit të Edukimit dhe Rregullorja e programit Bachelor në “Gjuhë angleze” përshkruhet procesi i regjistrimit të studentëve, i zhvillimit të procesit mësimor, i transferimit të studimeve, njohjes dhe njehsimit të diplomave, procedura e ankimimit dhe diplomimit të tyre. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019. Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 27.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018, Kreu III, Neni 46.</p> <p>Evidencë-2-Statuti UAMD, 2018, Neni 57, pika 4; Neni 64 dhe Neni 76.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton zbatimin e procedurave që garantojnë barazinë në çdo student. Procedura dhe kriteret specifike bëhen publike sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatin Akademik të UAMD. Procedura e përfitimi të bursave në UAMD është e barabartë për të gjithë studentët bazuar në meritën e përfitimit sipas politikave shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018, Kreu III, Neni 46.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 27.</p> <p>Evidencë-2-Statutii UAMD, 2018, Neni 57, 58, 64, 89.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik</p>	<p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja propozon për çdo vit akademik kriteret e pranimit të studentëve në programin mësimor, miratimi i të cilave bëhet nga Fakulteti dhe Senati</p>

<p>kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Akademik dhe vijon me MASR. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të UAMD, në rrjetet sociale të FE si edhe në portalin U-Albania.</p> <p>GVJ konstaton se procedura e hartimit dhe miratimit të kriterëve specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi është e mirëpërcaktuar në aktet rregullatore institucionale të UAMD. Procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në dosjen e plotë të programit të studimit.</p> <p>Evidencë-99-Të dhëna nga ëbsite-i i UAMD-së: http://ëëë.uamd.edu.al/.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 27.</p> <p>Evidencë-2-Statuti UAMD, 2018, Neni 74-76.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FE u vë në dispozicion informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është qartësisht i shprehur në rregulloret e institucionit. Departamenti i Gjuhëve të Huaja publikon online në faqen zyrtare të institucionit fituesit si dhe bën shpalljen e tyre në mjediset e brendshme të Fakultetit të Edukimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron bërjen publike të rregulloreve institucionale në faqen zyrtare të IAL në mënyrë që të jenë më lehtë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit.</i></p> <p>Evidencë-55-Miratimi i Kriterëve të Pranimit nga Senati Akademik.</p> <p>Evidencë-54-Kriteret e pranimit të propozuara nga Njësitë Kryesore.</p> <p>Evidencë-57-Shpërnarja e Kuotave të pranimit të studenteve Bachelor 2022-2023.</p> <p>Evidencë-96-Programi i Transparencës UAMD.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e</p>	<p>Kandidatët për studentë kanë disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në UAMD. Kandidatët për studentë dhe gjithë të interesuarit kanë disa mundësi për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në UAMD. FE në mënyrë periodike</p>




<p>përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>organizon ditë orientuese për maturantët. Këto takime organizohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditë të hapura informimi ku maturantët mund të vizitojnë ambientet universitare të FE, - Takime informuese në gjimnaze për maturantët - Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MASR ose Drejtorive Arsimore Rajonale - Takime informuese online me grupe maturanësh në rang gjimnazesh. <p>GVJ vlerëson impenjim maksimal të FE dhe stafit akademik të DGJH në informimin e publikut dhe të të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> <p>Evidencë-99-Të dhëna nga ëebsite-i i UAMD-së: http://ëëë.uamd.edu.al/.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Për çdo vit akademik, në kuotat e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” parashikohen edhe kuota të veçanta për aplikantë nga trojet, ata me statusin e jetimit, me aftësi të kufizuara dhe nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjta si për kandidatët e tjerë, por kuotat janë të dedikuara dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të ministrisë përgjëgjëse për arsimin e lartë. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të UAMD, në rrjetet sociale të FE si edhe në portalin U-Albania.</p> <p>Evidencë-55-Miratimi i Kritereve të Pranimi nga Senati Akademik.</p> <p>Evidencë-2-Statuti UAMD, 2018, Neni 74-76.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018, Kreu III, Neni 46.</p> <p>Evidencë-96-Programi i Transparencës UAMD.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në kuotat e programit Bachelor në “Gjuhë Angleze” parashikohen edhe kuota të veçanta për aplikantë të huaj. Kuotat janë të dedikuara dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të ministrisë përgjëgjëse për arsimin e lartë. Kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet e regjistrimeve publikohen në faqen zyrtare të UAMD, në rrjetet sociale të FE si edhe në portalin U-Albania</p> <p>Evidencë-55-Miratimi i Kritereve të Pranimi nga Senati Akademik.</p>




	Evidencë-54-Kriteret e Pranimit të Propozuara nga Njësitë Kryesore.			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë dhe për studentët me rezultate të larta akademike, krahas kategorive të studentëve me aftësi të veçanta, pakicave dhe shtresave të marxhinalizuara dhe shtetasve të huaj. Evidencë-57-Shpërndarja e Kuotave të pranimit të studenteve Bachelor 2022-2023.			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Edukimit, me të gjitha strukturat e tij, impenjohet maksimalisht në informimin e publikut dhe të të interesuarve në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</i> <i>GVJ sugjeron ngarkimin e rregulloreve institucionale në faqen zyrtare të IAL në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të aksesueshme nga studentët dhe të gjithë aktorët e interesuar. GVJ konfirmon se UAMD e përmbush këtë standard plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se FE vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi shërbejnë aktet normative në fuqi. Kështu, respektohet tërësia e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Studimeve të Institucionit, Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, Rregulloren e Departamentit si dhe në Rregulloren e Programit. Faqja e uebit www.uamd.edu.al , është një burim informacioni, lehtësisht i aksesueshëm. Të dhënat për kriteret dhe procedurat u bëhen të

	<p>njohura studentëve gjatë takimeve të tyre me Drejtuesin e Njesisë Bazë.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-7- Rregullore FE, 2019.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-96-Programi i transparencës UAMD, http://ëëë.uamd.edu.al/.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>UAMD ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë ata që gëzojnë statusin e studentit, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.</p> <p>Fakulteti i Edukimit, me anën e rregulloreve të miratuara vë në dispozicion kurrikulën e studimeve, planin mësimor, modulet dhe programin lëndor (syllabusin), ku përcaktohen objektivat e lëndëve, literatura e detyrueshme dhe ajo e sugjeruar, temat, orët e leksioneve/seminareve, organizimin në semestra si dhe kohëzgjatjen e kursit.</p> <p>Evidencë-36-Plani Mësimor për Programin Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-7- Rregullore FE, 2019.</p> <p>Evidencë-10-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja.</p> <p>Evidencë-13-Rregullore Bachelor Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-111- Syllabuset e Lëndëve.</p> <p>Evidencë-99-Të Dhëna nga ëësite-i i UAMD-së: http://ëëë.uamd.edu.al/.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer, GVJ konstatoi që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dijeve. Në fillim të çdo lënde apo moduli pedagogu përkatës i prezanton studentëve planin mësimor të lëndës së tij.</p> <p>Gjatë javës së orientimit (në fillim të vitit akademik) studentët informohen me komunikim të drejtpërdrejt në auditor nga drejtuesit e departamenteve dhe koordinatoret e programeve të studimit të cilët sqarojnë paqartësitë që studentët mund të kenë</p>




	<p>dhe mbajnë kontakte të vazhdueshme përgjatë vitit akademik me studentët. Vlerësimi i dijeve është i unifikuar në nivel IAL dhe sanksionohet në rregulloren e UAMD dhe rregulloren e FE sipas sipas kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - provimi i parë i ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë dhe/ose të tetë të semestrit, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar; - provimi përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë dhe/ose të gjashtëmbëdhjetë të semestrit, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar; - detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit, përmbajnë 100 pikë ose 10% e vlerësimit përfundimtar; <p>Më konkretisht, këto procedura parashikohen në Rregulloren e UAMD, Rregulloren e FE, Rregulloren e Sekretarisë Mësimore si dhe Rregulloren e Departamentit.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu III, Neni 46, 51, 57, 58, 60, 83 dhe Neni 89.</p> <p>Evidencë-9- Rregullore FE, 2019, Seksioni IV, Neni 23, 27, 28, 39 dhe Neni 40. Seksioni V, Neni 59.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Seksioni IV, Neni 18, Neni 19. Seksioni XI, Neni 42, gërma i dhe j.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentët janë të informuar mbi procedurat e punimit të temës së diplomës dhe /ose provimit të diplomimit. Pyetjet e provimit të diplomimit hartohen nga lektorët e FE të cilët janë të angazhuar në mësimdhënie në lëndët e formimit profesional. Studentët të cilët plotësojnë kriteret për të zhvilluar tezë diplome mund të zgjedhin një temë nga lista e temave të miratuara nga departamenti. Drejtuesi i departamentit, stafi akademik, koordinoret e programeve të studimit, faqja ëeb e FE dhe rrjetet sociale janë disa nga burimet e informacionit për studentët. Procedurat dhe kriteret parashikohen nga një mori rregulloresh dhe aktesh të miratuara nga Institucioni.</p> <p>Evidencë-32- Java e Orientimit dhe Guida e Studentit</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të</p>	<p>GVJ nga takimi me studentët evidentoi se ata kanë disa mundësi alternative për të marrë informacion rreth programeve të studimit të ofruara dhe mundësive që ofrohen në UAMD, si psh: ditë të hapura informimi në ambientet e FE, guida e studentit, ëeb site, rrjete sociale, broshura, takime informuese</p>




<p>posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>në gjimnaze, takime rajonale të organizuara nga DAR dhe takime informuese online. Institucioni ndjek një sërë politikash për të informuar studentët e interesuar mbi programin e studimit Bachelor në Gjuhë Angleze.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu III, Neni 53, 54, Neni 86.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”.</p> <p>Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>FE disponon informacion të plotë në lidhje me përparimin akademik të studentëve. Institucioni jep informacion të nevojshëm për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të përparimit të studentëve.</i></p> <p><i>FE përdor metoda alternative dhe efikase të komunikimit me studentët, përfshirë edhe rrjetet sociale. GVJ konfirmon se UAMD e përmbush plotësisht këtë standard.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen dhe të gjitha aspektet e aktiviteteve akademike të lidhura me avancimin e tyre akademik. Informacionin fillestar në lidhje me procesin mësimor studentët e marrin përmes sekretarisë mësimore në momentin e regjistrimit në programin e studimit. Në vijim, ata marrin informacion në ditët informuese, nga stafi akademik.</p> <p>Gjithashtu, informacione më të detajuara paraqiten në faqen ueb institucionale ku paraqitet struktura e vitit akademik përfshirë periudhat e leksioneve, provimeve, pushimeve dhe detyrimeve të tjera.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Seksioni IV, Nenet 14, 15, 18 dhe 19.</p>




	Evidencë-111-Të Dhëna nga ëebsite-i i UAMD-së.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Detajet në lidhje me përmbajtjen e lëndës, temat, shpërndarjen e tyre gjatë semestrit, mënyrën e vlerësimit, detyrimet akademike dhe administrative, jepen në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës, gjatë së cilës prezantohet edhe plan programi i lëndës. Studenti ka qasje të personalizuar në hapësirën e tij private të manaxhimit të ciklit akademik [Sistemi Pitagora] që nga regjistrimi në kurse, syllabusi i lëndëve, vlerësimet në secilin kurs deri në diplomim.</p> <p>Evidencë-124-Syllabuset e Lëndëve.</p> <p>Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Seksioni III, Nenet 20 dhe 21.</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës e cila funksionon në nivel institucional ofron në mënyrë të vazhdueshme për studentët: informacion dhe trajnim mbi situatën në tregun e punës, përgatitjen e CV-së profesionale, letrës së motivimit, etj, mundësi për zhvillimin e kompetencave, dhe lidhjen me bizneset. Për të prezantuar studentët me mundësitë e ofruara për praktika profesionale dhe punësim, Universiteti “Aleksandër Moisiu” organizon Panairin e Punës dhe Karrierës.</p> <p>Evidencë-29-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>Evidencë-72-Studentë të MP “Mësues i Gjuhës Angleze” të Punësuar.</p>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimit, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Përdomi i sistemit Pitagora u mundëson studentëve të UAMD-së informacion të përditësuar për të gjithë mbarëvajtjen e procesit mësimit. GVJ konstaton se studentëve u ofrohet nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit emri identifikues së bashku me fjalëkalimin për të hyrë në sistem, sikurse dhe manuali i përdorimit të sistemit. Studentët njoftohen në lidhje me afatet e regjistrimit, rregullat e regjistrimit, kurset e semestrit paraardhës si dhe detyrimet dhe penalitetet që rrjedhin nga mospagimi i detyrimeve. Shërbimet në funksion të realizimit të programit mësimit dhe kontaktet me administratën, sekretarinë, dhe stafin akademik përgjegjës për programin e studimit gjenden të përditësuar në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p>Evidencë-103-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.</p>

	<p>Evidencë-104-Manuali i Përdorimit të Pedagogut PITAGORA.</p> <p>Evidencë-106- Komunikim për përdorimin e Sistemit PITAGORA (RASH).</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit është i arritshëm lehtësisht nga studentët në distancë nëpërmjet lidhjes në internet. UAMD përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit Pitagora që ofrohet nga RASH. Në sistemin Pitagora mund të aksesohen të dhëna në lidhje me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, planin mësimor, syllabuset e lëndëve i cili është lehtësisht i aksesueshëm online. UAMD ka përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare një manual për studentët për akses në sistemin Pitagora.</p> <p>Evidencë-109-Programi i Transparencës UAMD.</p> <p>Evidencë-103-Rregullore e Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit.</p> <p>Evidencë-111-Të dhëna nga ëbsite-i i UAMD-së.</p> <p>Evidencë-113-Të dhëna nga faqja Facebook e FE.</p> <p>Evidencë-122-Informacione mbi Programin e Studimit në Facebook.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Faqja zyrtare e UAMD, sistemi i menaxhimit që përdor IAL dhe stafi akademik ofrojnë për studentët informacion të plotë e të hollësishëm në lidhje me objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</i></p> <p><i>Informacioni gjendet në rregulloret e miratuara, është i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit, ose jepet nëpërmjet Sekretarisë mësimore si dhe takimeve që zhvillohen në Njësinë Bazë. UAMD e përmbush plotësisht këtë standard.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>UAMD mban të dhëna statistikore vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve. Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore e FE-së e cila i hedh në regjistrin e diplomimeve sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe i përcjell ato tek drejtuesit e departamenteve dhe në zyrën e ALUMNI. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mbledh dhe përpunon të dhëna në lidhje me studentët e diplomuar në mënyrë periodike nga të gjitha njësitet kryesore të UAMD-së.</p> <p>Evidencë-47-Rregullore Sekretaria.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD-, Neni 89.</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019, Neni 65.</p> <p>Evidencë-79-Analiza Vjetore e Njësive Bazë në lidhje me MP “Mësues i Gjuhës Angleze”2021-2022</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë, të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në Sekretarinë Mësimore. GVJ ndërmori një vizitë në Sekretarinë Mësimore që administron të dhënat e studentëve nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në tre regjistra: Regjistri themeltar i studentëve; Regjistri i arritjeve akademike; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave.</p> <p>GVJ konstaton se regjistrimi i studentëve në procedurën e aplikimit dhe të pranimit është në përputhje me nenin 86 në Rregulloren e UAMD dhe në përputhje me aktet ligjore të përcaktuara nga MASR. Të dhënat e plotësuara për çdo student të regjistruar janë në renditje kohore me datën e regjistrimit të studentëve. Regjistri themeltar i studentëve është i plotësuar në përputhje me shtojcën Nr.2 të udhëzimit Nr.31 datë 16.09.2014 të MASR “Për pajisjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve”. GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studentëve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe plotësimi i regjistrit është në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe tërheqja e diplomës me suplementin bëhet nga vetë studenti ose përmes një</p>

Labele

Rlu

	<p>autorizimi të noterizuar. Këto të dhëna ruhen në hard copy dhe formë elektronike.</p> <p>Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi verifikuar në sekretarinë mësimore për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:</p> <p>Viti Akademik 2021 – 2022 58 studentë; Viti Akademik 2022 – 2023 50 studentë; Viti Akademik 2023 – 2024 31 studentë;</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat e studentëve mbahen në Regjistrat bazë që ruhen në mënyrë të përhershme në përputhje me ligjin “Për Arkivat” dhe janë objekt kontrolli. Ky proces realizohet nga personat e autorizuar, të cilët në përfundim të sezoneve të provimeve dhe riprovimeve mbledhin procesverbalet ku studenti është vlerësuar me notë dhe i hedhin në bazën elektronike të të dhënave. Të dhënat ruhen edhe në sistemin e menaxhimit të universitetit Pitagora që ofrohet nga RASH dhe garanton ruajtjen e konfidencialitetit dhe vërtetësinë e të dhënave. Disa nga funksionalitetet për studentët që mundëson sistemi Pitagora janë: regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj. Bazuar në politikat e sigurisë dhe të ruajtjes së informacionit këto të dhëna janë konfidenciale, por njëkohësisht edhe të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Neni 83 dhe Neni 89.</p> <p>Evidencë-110-Ligji nr.9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p> <p>Evidencë-47-Rregullore Sekretaria</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me</p>	<p>Në funksion të procesit të vlerësimit dhe mbikëqyrjes së brendshme, përmes njësisë së Auditit të Brendshëm, Institucioni siguron zbatimin e duhur dhe respektimin e legjislacionit. Kjo strukturë ndihmon në mënyrë sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar menaxhimin si dhe proceset e kontrollit të brendshëm. Sekretaria Mësimore bën pasqyrimin e ecures së studentëve për çdo lëndë në Regjistrat e arritjeve akademike.</p> <p>Evidencë-58-Mesatarja në Hyrje në UAMD, 2017-2018 vs. 2018-2019.</p>




veprimtarinë e tyre përkatëse.									
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit si edhe pas takimeve me GVB dhe Stafin akademik, GVJ konstaton se Departamenti i Gjuhëve të Huaja analizon ecurinë e procesit mësimor. Analiza mësimore vjetore e departamentit për programin “Gjuhë Angleze” bazohet mbi raportet analitike të cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve të ofruar nga Sekretaria Mësimore. Databaza e hartuar nga Zyra e Alumnit përditësohet vazhdimisht edhe në lidhje me punësimin e ish-studentëve të UAMD-së. FE, për të përmirësuar objektivat e programit të studimit, ndjek rekomandimet e raportit të realizuar nga zyra e Alumnit dhe Karrierës për analizimin e të dhënave mbi punësimin e studentëve dhe studimin e kurrikulës dhe syllabuseve.</p> <p>Evidencë-58-Mesatarja në Hyrje në UAMD, 2017-2018 vs. 2018-2019.</p> <p>Evidencë-72-Studentë të MP “Mësues i Gjuhës Angleze” të Punësuar.</p>								
Konkluzione	<p><i>Spektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pjesë e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike është struktura përgjegjëse në UAMD që mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Të dhënat statistikore në lidhje me ecurinë e studentëve ruhen si në formën elektronike dhe fizike.</i></p> <p><i>Për sa më sipër, GVJ konstaton se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve




<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në nenin 115, të Rregullores së UAMD-se studentët kanë të drejtë të përfaqësohen dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në të gjitha organet drejtuese të UAMD-së. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik të UAMD, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësie kryesore si dhe në komisione të përhershme si NJBSC, Këshillin e Etikës etj.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu VI, Neni 115, Neni 21.</p> <p>Evidencë-3-Statuti UAMD-, Neni 79, 80, 88 dhe Neni 90.</p> <p>Evidencë-9-Rregullore FE, 2019.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2019.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje. Studentët kanë përfaqësimin e tyre në organet kolegjiale vendimmarrëse si: Senatin Akademik të UAMD, Këshillin e Etikës në UAMD, Njesinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni, Komisionin Institucional Zgjedhor – UAMD, Komisionin e zgjedhjeve në FE. Studentët gjithashtu janë pjesë e vlerësimit të personelit akademik. Studentëve u shpërndahen pyetësorë nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë, lidhur me performancën e personelit akademik. Pyetësorët plotësohen në mungesë të personelit akademik dhe ruajnë anonimatën e studentit. Rezultatet e anketimit nga studentët pasqyrohen në Raportin e Performancës së Personelit Akademik.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Kreu VI, Neni 115.</p> <p>Evidencë-82-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit.</p> <p>Evidencë-20- Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Evidencë-21-Rezultatet nga Anketimi i Studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik të FE, GVJ konstatoi se ndryshimi i kurrikulës së programeve të studimit në FE realizohet në mënyrë periodike. Ndryshimet afatshkurtra në programin e studimit reflektohen nga titullari i lëndës në syllabuset e lëndëve. Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve, në bazë të Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, realizon periodikisht anketime të studentëve, stafit akademik dhe administratës.</p>




departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.									
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Në anketime studentët shprehin opinionin e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies për personelin akademik dhe lëndët e frekuentuara në çdo semestër mësimor. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelit akademik, përgjegjësit e njësisë bazë analizojnë rezultatet e ankimimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuara për përmirësimin e tyre në të ardhmen.</p> <p>Evidencë-12-Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2019.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019.</p> <p>Evidencë-21-Rezultatet nga Anketimi i Studentëve.</p>								
Konkluzione	<p><i>Studentët me përfaqësuesit e tyre angazhohen në organet vendimmarrëse e këshilluese. Opinioni i studentëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik dhe reflektohet në përshtatjen e mësimdhënies, orareve mësimore, shpërndarjes së provimeve etj.</i></p> <p><i>GVJ konfirmon se UAMD e përmbush këtë standard plotësisht.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6


Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UAMD ka në përbërje të tij Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, i cili është në shërbim të informimit të studentëve. Ky sektor është përgjegjës për shërbimin e informacionit dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët dhe me palë të treta. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në UAMD i informon vazhdimisht studentët e FE, me anë të postës elektronike, me informacione për avancimin

	<p>e tyre akademik dhe karrierën pas universitare. Informimi i studentëve sigurohet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takimet informuese me maturantët; - Panairi i punës - Faqja ueb e UAMD dhe FE dhe rrejtet sociale Facebook dhe Instagram; - Organet drejtuese dhe Stafi akademik i cili në fillim të çdo lënde paraqet përmbajtjen e tij, format e mësimdhënies, detyrimet e studentëve dhe leksionet; - Sekretaria mësimore e cila informon studentët për tarifatat e regjistrimit, progresin e tyre, rezultatet e provimeve deri në procesin e diplomimit duke ofruar asistencë dhe informim të vazhdueshëm; - Platforma Pitagora; - Broshura, Guida e Studentit 22-23, fletëpalosje janë një formë që kanë rritur edhe informimin e publikut dhe studentëve në lidhje me programet mësimore; - Komunikim në rrjetet sociale me profil zyrtar të UAMD dhe të FE-së <p>Evidencë-50-Numri i Personelit Ndhmës Akademik në Departament dhe Program.</p> <p>Evidencë-47-Rregullore Sekretaria.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>UAMD ofron asistencë, këshillim dhe ndjek progresin e studentëve përmes strukturave të cilat funksionojnë bazuar në organigramën e UAMD. Ndër strukturat kryesore bazë mbështetëse për studentët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në UAMD, - Sekretaria mësimore, - Faqet ueb [ëëë.uamd.edu.al] dhe rrjetet sociale - Mjediset e dedikuara për njoftime në fakultet - Koordinatorët e programeve të studimit. <p>Vlen të përmendet që UAMD mbështet edhe klubet studentore që kanë si qëllim forcimin e kapaciteteve dhe promovimin e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në jetën universitare. UAMD organizon aktivitete që ndihmojnë studentët të menaxhojnë më mirë jetën studentore dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin për të arritur qëllime të përbashkëta. Nga takimi me studentet GVJ konstaton klube si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klubi i Librit, - Klubi i Multimedias dhe Fotografisë,




	<ul style="list-style-type: none"> - Klubi i Debatit, - Klubi i Juristëve të Rinj, - Klubi artit - Klubi Diplomantik - Klubi i Shahut - Klubi Volejbollit - StartUp UAMD etj. <p>Evidencë-65-Mbi Organizimin e Tutorialit/Mentorimit në UAMD.</p> <p>Evidencë-67-Ndarja e Mentorimit në Departament-Shembull.</p> <p>Evidencë-29-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës realizon këshillim në lidhje zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve. Ky sektor organizon dhe koordinon aktivitetet për studentët si: trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar etj. Ky sektor u ofron studentëve informacion në lidhje me realizimin e procesit mësimor, orientimin mbi praktikën profesionale si dhe këshillim karriere në lidhje me qasjen e tyre në tregun e punës duke i informuar mbi shkrimin e një CV-je, letrat e motivimit, si duhet të sillen gjatë një interviste pune etj.</p> <p>Evidencë-34- Studentët e trajnuar nga Zyra e Karrierës.</p> <p>Evidencë-31-Takime Alumni UAMD.</p> <p>Evidencë-33- Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Specialistët për këshillimin e karrierës dhe ALUMNI mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentë edhe mbas diplomimit si informacion i nevojshëm për vlerësimin periodik të programeve të studimit të ofruara në UAMD. Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve, në bazë të Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, realizon periodikisht anketime të studentëve. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës krijon databazën Alumni me të dhënat e studentëve në lidhje me punësimin e tyre. Kjo databazë rifreskohet vazhdimisht nga mbledhja e të dhënave të reja që mblidhen elektronikisht përmes një pyetëtori. Të dhënat nga databaza i vihen në dispozicion organeve drejtuese të UAMD.</p>




	<p>Vlen të theksohet që, GVJ vlerëson pozitivisht nismën e krijimit të Shoqatës Alumni, me objektiv mbështetjen e studentëve në drejtim të njoftimeve për punësim, shkëmbim përvojash, trajnime, seminare, ëorkshope etj.</p> <p>Evidencë-29-Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>Evidencë-33- Njoftime për punësim të studentëve dhe Alumni.</p>			
Konkluzione	<p><i>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës në UAMD, ndihmon në pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave etj. dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët.</i></p> <p><i>Vlen të theksohet që, GVJ vlerëson pozitivisht nismën e krijimit të Shoqatës Alumni, me objektiv mbështetjen e studentëve në drejtim të njoftimeve për punësim, shkëmbim përvojash, trajnime, seminare, ëorkshope etj. GVJ shprehet se ky kriter përmbushet plotësisht nga UAMD.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatojmë se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për monitorimin dhe vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Në UAMD funksionon Qendra për Edukim në Vazhdim e cila në bazë të rregullores së saj ka si detyrë hartimin e udhëzuesve për

<p>mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>personelin akademik në lidhje me metodat e mësimdhënies dhe organizon përgjatë gjithë vitit akademik trajnime për personelin akademik. Qendra për Edukim në Vazhdim ka hartuar disa module për trajnimin e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm dhe për rritjen e kapaciteteve akademike.</p> <p><i>Evidencë-3-Statuti UAMD, Kreu VII, Neni 77.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse në UAMD, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e Standardeve të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie; - Vlerësimin të Përgjegjësit të Departamentit për çdo anëtar të stafit; <p>Zyra e Degës Mësimore monitoron praninë e lektorëve në auditorë.</p> <p><i>Evidencë -4-Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë-84-Urdhri i Rektoratit mbi Transparencën e Marrëdhënies Student-Pedagog.</i></p> <p><i>Evidencë-22-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE.</i></p> <p><i>Evidencë-23-Raporti i Vlerësimin të Cilësisë së Brendshme FE.</i></p> <p><i>Evidencë-25-Ngritja e Komisionit të Vlerësimin të Brendshëm të FE-së.</i></p> <p><i>Evidencë-90-Baza e Kërkimit Shkencor në Njësinë Bazë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve dhe të ankimimeve sanksionohet në Rregulloren e institucionit dhe zbatohet nga strukturat përkatëse në nivel institucional, njësie kryesore dhe njësie bazë. Studentët janë të përfshirë në të gjithë strukturat vendimarrëse kolegjiale të UAMD-së. Në fund të çdo semestri, studentëve u jepet një pyetësor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Nga takimi me studentët u theksua marrja e mendimit në mënyrë të vazhdueshme gjatë semestrit</p>




	<p>në lidhje me temat e trajtuara. Plotësimi i pyetësorëve zhvillohet dy herë gjatë vitit akademik, në të dy semestrat bazuar në nenin 6 të Rregullores së NJSBC.</p> <p>Evidencë-83-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet dhe analizat e pyetësorëve i vihen në dispozicion individualisht me email, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamenteve, si dhe dekanëve përkatës nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë në Rektorat. Departamenti i Gjuhëve të Huaja, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit “Gjuhë Angleze”, bën publike rezultatet e vlerësimit nëpërmjet analizës vjetore të njësisë bazë.</p> <p>Evidencë-95-Vendim i Senatit Akademik nr.32 mbi Menaxhimin e Fondit Bazë të Kërkimit Shkencor nga Njësitë e UAMD.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD, Neni 69.</p> <p>Evidencë-20- Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Evidencë-68-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019.</p> <p>Evidencë-81-Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore shkencore.</p> <p>Evidencë-92-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në përmbushje të misionit të tij UAMD promovon shembuj të praktikave të mira, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar nga universitete të huaja. UAMD ndjek një politikë integruese dhe ndërkombëtarizuese për stafin akademik. Personeli akademik dhe administrativ ka qenë pjesë e mobiliteteve duke sjellë në institucion përfitime profesionale dhe duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimeve si rrjedhojë e këtyre mobiliteteve.</p> <p>Evidencë-78- Mobilitete të Stafit Akademik FE.</p>
	<p>Evidencë-83-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët.</p> <p>Evidencë-94-Formulari i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik.</p>

	Evidencë-93-Raporti i Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të Departamentit, 2019-2020.			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka ngritur struktura dhe ka miratuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Rezultatet dhe analizat e pyetësorëve i vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, Përgjegjësve të Departamenteve, si dhe Dekanëve dhe problematikat dhe plani i masave diskutohen deri në nivel departamenti.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se UAMD e përmbush plotësisht këtë standard.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2


Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UAMD është Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë e cila funksionon mbi bazën e Rregullores se Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe nga takimet me përfaqësues nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Në nivel institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Koordinatori Institucional pranë ASCAL, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë.</p> <p>Në nivel fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi dhe Koordinatorët e Programeve. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është</p>

	<p>struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit.</p> <p>Evidencë-3-Statuti UAMD, Kreu VII.</p> <p>Evidencë-20- Rregullore per Sigurimin e Cilesise, Neni 8-9.</p> <p>Evidencë-24-Vendim Dekanati për krijimin e GVB-ve mbi Akreditimin e Programeve të studimit në FE.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga maksimumi 7 anëtarë me përfaqësues nga secila Njësi Kryesore e UAMD-së, përfshirë edhe një student me mesatare mbi 9. Anëtarët e Komisionit vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar. Funksionimi i këtij komisioni bazohet në rregulloren përkatëse.</p> <p>Në nivel institucional funksionon edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e ngritur me Urdhër të Rektorit me 7 anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së, drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, dhe një përfaqësues nga studentët. Kjo njësi realizon raporte periodike të vetëvlerësimit në bashkëveprim me Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel fakulteti.</p> <p>Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, GVJ konstaton se, GVB është ngritur në përputhje me Statutin e UAMD në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së FE dhe të UAMD-së. GVB ka hartuar RVV në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, dhe bazuar në dokumentat që i janë vënë në dispozicion.</p> <p>Evidencë-20- Rregullore per Sigurimin e Cilesise, Neni 9.</p> <p>Evidencë-94-Formulari i Vlerësimit të Stafit Akademik nga Studentët.</p> <p>Evidencë-4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes</p>	<p>Sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 18, datë 24.03.2022 “Për akreditimin periodik Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Moisiu” Durrës, është vendosur Akreditimi Institucional i UAMD, me vlerësim përfundimtar pozitiv, me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së Akreditimit Institucional është 23/03/2026.</p>




<p>proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”, me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL .</p> <p>Evidencë-76Vendimi i Bordit të Akreditimit për UAMD, 2017.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ka në kompetencat e tij kontrollin dhe miratimin e raporteve 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm.</p> <p>Bazuar në instrumentat e brendshëm për sigurimin e cilësisë, UAMD përcakton direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe proceset kryesore të sigurimit të cilësisë. Përveç monitorimit të rregullt (çdo vit dhe pjesërisht edhe çdo semestër) dhe përmirësimit, baza kryesore e këtyre aktiviteteve janë vetëvlerësimet që mund të zhvillohen së paku çdo gjashtë vjet në funksion të proceseve të akreditimit nga ASCAL. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në takimet me stafin akademik, GVB dhe me përfaqësues nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ gjykon që UAMD ka identifikuar tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për monitorimin e standarteve të cilësisë.</p> <p>Evidencë-8-Raporti Vjetor UAMD.</p> <p>Evidencë-79-Analiza Vjetore e Njesisë Bazë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, UAMD ka ngritur struktura institucionale dhe struktura ne nivel fakulteti, të cilat funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme institucionale.</i></p>
	<p><i>Në mënyrë të përvitshme, institucioni harton raportet e veprimtarisë institucionale ku përfshihen analiza e procesit mësimor dhe raportet e analizës së veprimtarisë shkencore. GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>UAMD përdor mekanizma të ndryshëm për mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit Bachelor. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kryen në mënyrë periodike vlerësimin e programit të studimit. Pyetësorët e ndërtuar kanë për qëllim vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të institucionit. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen në mënyrë statistikore dhe shërbejnë si bazë të dhënash edhe nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në hartimin e raportit në kuadër të akreditimit të programeve të studimit. Zyra e Alumnit dhe Karrierës harton pyetësorë që targetojnë kompanitë dhe Alumnin. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse të cilët në varësi të problematikave marrin masa për përmirësimin e treguesve.</p> <p>Në rast se departamenti propozon rishikimin e një programi ekzistues apo kërkon hapjen e një programi të ri, bëhet një analizë që lidhet me nevojat e tregut të punës dhe me përmirësimin e programeve ekzistuese. Pasi është bërë edhe një analizë e burimeve njerëzore dhe e infrastrukturës që do të përfshihet në këtë proces, procedura vazhdon me përcjelljen e informacionit në Dekanat dhe më pas Dekanati e përcjell atë në Senatin Akademik për miratim.</p> <p>Evidencë-20- Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, Neni 6, 12.</p> <p>Evidencë-93-Raporti i Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022.</p> <p>Evidencë-4-Plani i Zhvillimit Strategjik UAMD, 2020-2025.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi dokumentacion mbi raportet e përgatitura nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UAMD për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, dhe anketime semestrale studentore mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi të ofruara nga IAL.</p>

<p>praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Bazuar mbi raportet e anketimeve por edhe ato të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm institucional ose për programe studimi, hartohet Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë ku jepen rekomandime për rritjen e cilësisë në UAMD.</p> <p>Departamenti i Gjuhëve të Huaja harton në mënyrë të përvitshme një analizë të detyruar të punës mësimore, ku përfshihen mangësitë dhe sugjerimet përkatëse për t'i kapërcyer ato. Këto raporte janë të përvitshme dhe në të publikohen rezultatet e vlerësimit. Kjo analizë shoqërohet edhe me një plan masash që adresojnë problematikat e evidentuara.</p> <p><i>Në dokumentacionin e paraqitur nga IAL, GVJ nuk gjen një plan të qartë pune me objektiva të matshëm për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë në IAL. GVJ vlerëson punën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përgatitjen e Raporteve të vlerësimit dhe <u>sugjeron</u> që kjo njësi të bashkëpunojë me strukturat akademike të institucionit për përgatitjen e planit të masave dhe ndjekjen e shkallës së përmbushjes së tyre.</i></p> <p>Evidencë-20- Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, Neni 16.</p> <p>Evidencë-90-Baza e Kërkimit Shkencor në Njësinë Bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>UAMD përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze”.</p> <p>Cilësia e mësimdhënies dhe kurrikulës kontrollohet dhe monitorohet nga Drejtuesi i Departamentit, i cili bazuar në rregulloren e FE mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, paraqitjen dhe disiplinën në punë dhe realizon analizat periodike të Departamentit. Bazuar në rregulloren e FE, Zv/Dekani për anën mësimore, ndjek përgatitjen dhe zbatimin e planeve e programeve mësimore dhe te orarit mësimor të FE dhe mbikqyr zhvillimin e aktiviteteve didaktike konform strukturës mësimore dhe orarit mësimor të miratuar. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga njësi bazë dhe ajo kryesore realizohet duke përdorur raportet e hartuara nga stafi akademik në lidhje me mësimdhënien të dhënat e ofruara nga sekretaria mësimore, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të programit të studimit, opinioni i studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie opinioni i përfaqësuesve të biznesit, anketimi i studentëve të diplomuar etj.</p>




<p>shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Evidencë-20- Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 3.</p> <p>Evidencë-82-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit.</p> <p>Evidencë-68-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mbështetur nga njësitë kryesore në IAL, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pyetësorë drejtuar studentëve për të marrë mendim në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe vlefshmërinë e tij tek ALUMNI - pyetësorë në formë elektronike drejtuar kompanive për të analizuar performancën dhe përgatitjen e njohurive praktike që kanë studentët e diplomuar - ëorkshope/panaire pune ku mbledh sugjerimet dhe kërkesat e bizneseve në lidhje me programet e studimeve. <p>Gjithashtu, institucioni vlerëson edhe angazhimin administrativ dhe kërkimor shkencor të stafit akademik dhe të studentëve. Një tjetër instrument i përdorur nga institucioni është edhe sondazhi institucional.</p> <p>Evidencë-44-Studimi i tregut të punës pas Diplomimit të Studentëve, Shtator 2020.</p> <p>Evidencë-82-Formulari i Vlerësimit të Programit të Studimit.</p> <p>Evidencë-68-Rezultatet e Vlerësimit të Stafit Akademik, 2018-2019.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p> <p><i>Lidhur me këtë standard, GVJ konstaton se ai përmbushet plotësisht. GVJ vlerëson pozitivisht punën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përgatitjen e raporteve të vlerësimit dhe rekomandimeve të bëra dhe sugjeron që kjo njësi të bashkëpunojë me strukturat akademike të institucionit për përgatitjen e një plani masash veprimi për adresimin e problematikave dhe ndjekjen e shkallës së përmbushjes së tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentet bazë institucionale (Statuti dhe Rregullorja e UAMD, Kodi i Etikës dhe Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë) dhe vizitat në institucion konstaton se në institucion funksionon sistemi i vlerësimit të brendshëm ku përfshihen aktorë në nivel Institucional (Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Koordinatori Institucional pranë ASCAL, Drejtorja e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë), në nivel Fakulteti (Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program, Koordinatorët e Programeve) dhe studentët.</p> <p>Studentët janë të përfaqësuar në çdo organ kolegjal duke filluar nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit NJSC e deri te GVB. Studentët marrin pjesë në mbledhjet e Dekanatit dhe departamentit kur trajtohen çështje që kanë lidhje me ta. GVJ konstaton që institucioni parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm të aktorëve të brendshëm stafit akademik, stafit joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionit.</p> <p>Evidencë-5-Rregullore UAMD. Evidencë-9-Rregullore FE.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe nga takimet e kryera në institucion, GVJ konstaton se strukturat e brendshme përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në institucion kanë detyra të përcaktuara qartë në aktet rregullatore të brendshme. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Senati Akademik, – Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë, – Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,




	<ul style="list-style-type: none"> - Koordinatori Institucional pranë ASCAL, - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve, - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program studimi, - Koordinatorët e Programeve. <p>Evid. 3. Rregullore UAMD, Evidencë-20-Rregullore per Sigurimin e Cilesise, Neni 3.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Gjuhë angleze” janë përfshirë staf akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentë. Strukturat e institucionit bashkëveprojnë në rritjen e cilësisë. Gjatë takimeve GVJ konstatoi se personeli akademik dhe stafi administrativ menaxhojnë dhe zbatojnë procedurat e sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Institucionit dhe me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm cilësisë.</p> <p>Evidencë-3-Statuti UAMD, 2018, kreu VII, Neni 77/78 dhe 80.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se në grupet e vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe grade apo kualifikimi akademik.</p> <p>Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve. Ky proces përfshin procesin e vetëvlerësimit nga ana e pedagogut, vlerësimit nga eprorët dhe nga studentët. Gjithashtu, në hartimin e raporteve dhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në rregulloren institucionale të sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me</p>	<p>GVJ u informua gjatë takimeve në institucion se në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshihen edhe ekspertë të jashtëm. Këta bashkëpunëtorë kontribuojnë me mendimet dhe ekspertizën e tyre në përmirësimin e cilësisë së institucionit e cila realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimit të ëorkshopeve dhe praktikave mësimore pranë kompanive partnere;




<p>programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përvojës së ish-studentëve të diplomuar; - Analizës së përputhshmërisë së planit mësimor dhe syllabuseve përkatëse me atë të ofruar në IAL të ngjashme jashtë vendit; <p>GVJ vlerëson se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi realizon një vlerësim objektiv të programit të studimit dhe nevojave për rishikimin e tij. Gjithashtu si UAMD ashtu edhe FE dhe Departamenti i Gjuhëve të Huaja konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta gjatë organizimit të takimeve apo konferencave me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtij programi studimi.</p> <p>Evidencë-77-Marrëveshje Bashkëpunimi me DAR.</p> <p>Evidencë-66-Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD.</p> <p>Evidencë-43- Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD me Erasmus.</p> <p>Evidencë-2-Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD garanton që procedurat e sigurimit të cilësisë të demonstrojnë transparencë dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët e saj. Strukturat e institucionit bashkëveprojnë dhe sigurojnë një shërbim cilësor në nxitjen dhe rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. Garantohet integriteti akademik dhe shmangjet diskriminimi apo pabarazitë kundrejt personelit dhe studentëve. Mbështetur në sa më sipër GVJ konstaton se standardi përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X


<p>Standardi VI.5</p> <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë</p>	<p>GVJ konstaton se politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit gjenden në faqen ëeb të universitetit. Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e</p>




<p>transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>rezultateve) është transparent dhe u komunikohet individualisht studenteve dhe të gjithë aktorëve në tjerë.</p> <p>Evidencë-96-Programi i Transparencës UAMD.</p> <p>Evidencë-99-Të Dhëna nga ëbsite-i i UAMD-së: http://ëëë.uamd.edu.al/.</p> <p>Evidencë-4-Rregullore UAMD, 2018.</p> <p>Evidencë-17-Rregullorja për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte të vlerësimit të brendshëm të cilat ruhen në arkivën institucionale në përputhje me normat e ligjit nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat” me normat tekniko -profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, në Rregulloren e Njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike ne Republikën e Shqipërisë si dhe legjislacionin për të dhënat personale për të gjithë individët e përfshirë në këtë proces. Të gjitha të dhënat në UAMD përpunohen dhe bëhen publike duke zbatuar Kodin e Etikës për konfidencialitetin e të dhënave personale. Rezultatet e vlerësimeve u vihen në dispozicion individualisht të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, Përgjegjësave të Departamenteve dhe Dekanëve përkatës.</p> <p>Evidencë-7-Kodi i Etikës UAMD.</p> <p>Evidencë-119-Booklet UAMD.</p> <p>Evidencë-120-Broshura Para Promovimit.</p> <p>Evidencë-121-Broshura pas Promovimit.</p> <p>Evidencë-117-Politika dhe Strategjia e Komunikimit dhe Marketimit të Institucionit.</p> <p>Evidencë-118-Gjumnazet nga Vijnë Studentet.</p> <p>Evidencë-89-Raport mbi Aktivitetin Kërkimor-Shkencor UAMD, 2018-2019</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional, harton në mënyrë periodike raporte në funksion të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë si për program studimi ashtu edhe në nivel institucional. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët</p>




<p>mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Masat e marra për stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm në rastin e vlerësimeve nën nivelin mesatar janë të sanksionura në Rregulloren e UAMD dhe rregulloren e FE.</p> <p>Evidencë-15-Rregullore, Master Profesional “Mësues i Gjuhës Angleze”, 2019.</p> <p>Evidencë-92-Raporti mbi Veprimtarinë Mësimore-Shkencore të Departamentit, 2021-2022.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në UAMD, nëpërmjet Qendrës për Edukim në Vazhdim janë organizuar trajnime informuese për stafin akademik dhe studentët, ndër të cilat ato me temë: Organizimi i Brendshëm Institucional dhe Vlerësimi i Vazhdueshëm që synojnë informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve për rolin e tyre në sigurimin e cilësisë.</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në FE është riorganizuar në vitin 2021 dhe ka në përbërjen e saj një staf akademik të konsoliduar dhe perfaqësues nga studentët. GVJ konstaton angazhim maksimal nga ana e UAMD në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit.</p> <p>Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE.</p> <p>Evidencë-6-Raporti Vjetor UAMD.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në takimet e realizuara, na u konfirmua se Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Këtu përfshihen takime me studentët në auditorë, plotësimi i pyetësorëve etj. UAMD përfshin të gjitha organet e brendshme në trajnime periodike me qëllim sigurimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve njerezore dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Bazuar në rregulloren e brendshme dhe institucionale, FE ka caktuar një kordinator për çdo program studimi që ofron, i cili/e cila është pjesë e grupit të punës për hartimin e kurrikulës. Ai/ajo ndjek ecurinë e studentëve dhe trajton problematikat e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve dhe informon në mënyrë të vazhdueshme drejtuesin e njësisë kryesore / bazë në lidhje me ecurinë e programit të studimit. Në fillim/fund viti akademik bëhet mbledhja e asamblesë me Rektorin, ku paraqitet raporti vjetor i UAMD-së.</p>




	<p>Evidencë-20-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE, 2015.</p> <p>Evidencë-12-Strategjia e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 2020-2025.</p> <p>Evidencë-19-Politika dhe Strategjia e Sigurimit të Cilësisë së Brendshme, FE .</p> <p>Evidencë-7-Rregullore FE, 2019.</p> <p>Evidencë-6-Raporti Vjetor UAMD.</p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni paraqet njohje mbi polikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të cilat janë të sanksionuara në Rregulloret e Institucionit.GVJ e konsideron këtë standard të përmbushur plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Gjuhë Angleze”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Angleze është në përputhje me misionin, strategjinë e institucionit, fushën akademike të departamentit dhe nevojat e tregut. Departamenti i Gjuhëve të Huaja kryen rishikimin e përditësimin e kurrikulave mbështetur në legjisllacionin në fuqi dhe dokumentat përkatëse. Programi garanton përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat e përcaktuara;
2. Programet e studimit respektojnë standardet akademike. Plani mësimor, syllabuset, metodat e mësimdhënies e mësimnxënies janë hartuar sipas kërkesave të standardeve akademike;
3. Hartimi dhe përdorimi i një dokumentacioni ligjor në nivel institucional dhe të programit (Statuti UAMD, Rregullore UAMD, Rregullore FE, Rregullore e Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Plani Strategjik i Zhvillimit të Programit Gjuhë Angleze etj), dëshmojnë për një veprimtari të institucionalizuar, të strukturuar dhe të standardizuar. Krijimi i një strukture të

- kompletuar, i njëjësive koordinuese dhe sigurimit të cilësisë kanë ndihmuar në një menaxhim më të efektshëm, delegim të detyrave dhe përbushje më të mirë të tyre;
4. Programi realizohet nga një staf akademik i kualifikuar, i diplomuar dhe trajnuar në vendet perëndimore, me një përvojë të gjatë në mësimdhënie, tregues që garanton një cilësi të lartë të programit;
 5. Programi ofrohet në gjuhën angleze që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencave gjuhësore të studentëve si dhe në mundësinë më të lartë për t'u ofruar studentëve literaturë të përditësuar dhe bashkëkohore;
 6. Godina Nr.1, në kampusin e ri, ku gjendet Departamenti i Gjuhëve të Huaja ofron kushte infrastrukturore optimale për mbarëvajtjen e një procesi normal mësimor;
 7. Sistemi i informacionit është efektiv. Administrimi online i të dhënave nga njësia kryesore ka rritur cilësinë e shërbimeve dhe transparencën ndaj studentëve;
 8. Institucioni mbështet dhe nxit kërkimin shkencor të stafit. Një aspekt tregues i kësaj mbështetjeje është financimi i kostove individuale të pedagogëve për kërkimin shkencor;
 9. Institucioni ka njësi dhe procedura të posaçme për orientimin dhe këshillimin e studentëve. Institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe sigurimit të cilësisë së tyre;

b. Pika të dobëta:

1. Mungesa e specifikimit të numrit të krediteve të secilës lëndë në aktivitetet e saj didaktike formuese, në syllabus, sjell një mangësi në transferimin e studimeve nga UAMD drejt institucioneve të tjera brenda dhe jashtë vendit; (*Standarti II.1, kriteri 1*)
2. Literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse nuk ishte e përditësuar me literaturë të viteve të fundit në të gjitha lëndët e programit ; (*Standarti II.4, kriteri 5; Standarti IV.3, kriteri 1*)
3. Mungesë e librave fizikë për lëndët e programit të studimit në bibliotekë; (*Standarti IV.3, kriteri 4*)
4. Mungesa e paraqitjes së vlerësimit me shkronjë sipas sistemit amerikan në syllabuse, në përputhje me aktet e tjera rregullatore të institucionit, sikurse është rregullorja e njësive kryesore dhe suplementi i diplomës; (*Standarti II.3, kriteri 2*)

Rekomandime

1. GVJ rekomandon institucionin të unifikojë syllabuset dhe planin mësimor në përputhje me VKM Nr.41 e ndryshuar duke saktësuar kreditet dhe orët mësimore për secilin aktivitet;
2. GVJ rekomandon që të përditësohen syllabuset me literaturë të 5 viteve të fundit;
3. GVJ rekomandon forcimin e rolit të bibliotekës së UAMD dhe pasurimin e saj me më shumë libra fizik të viteve të fundit, në gjuhën angleze, por edhe në gjuhë të tjera. Gjithashtu rekomandohet pasurimi i bibliotekës me fjalorë për përdorim brenda mjediseve të bibliotekës;

4. GVJ rekomandon që syllabuset të paraqesin informacion rreth mënyrës së vlerësimit në notë dhe me shkronja sipas sistemit Amerikan, në përputhje me aktet e tjera rregullatore të institucionit, sikurse është rregullorja e njësisë kryesore dhe suplementi i diplomës;
5. GVJ rekomandon të bëhet një kombinimi i vlerësimit me gojë dhe me shkrim, për vetë specifikën e programit;
6. GVJ rekomandon më tepër vëmendje në përfshirjen e të gjithë aktorëve të IAL deri në nivel departamenti në procedurën e parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe kritereve për akses në fondet e brendshme të kërkimit shkencor, përfshirë edhe mbështjen për pjesëmarrje në konferenca apo për botime shkencore;
7. GVJ rekomandon që për punimet e diplomës dhe detyrave të kursit institucioni të investojë në sigurimin e një programi antiplagjaturë;

Conclusions of the Evaluation for the first cycle study program Bachelor in English Language"

a. Strengths and affirmations:

1. The Bachelor study program in English aligns with the institution's mission, strategic objectives, the academic focus of the department, and the demands of the job market. The Department of Foreign Languages regularly reviews and updates the curricula in accordance with prevailing legislation and relevant guidelines. This program ensures that students receive an education that meets predefined objectives;
2. The study program adheres to established academic criteria. Its curriculum, teaching schedule, course outlines, and instructional methodologies conform to the requisite academic standards;
3. The creation and utilization of legal documentation at both institutional and program levels (including the UAMD Statute, UAMD Regulations, FE Regulations, Regulations of the Department of Foreign Languages, Strategic Plan for the Development of the English Language Program, etc.) signify a structured, standardized, and institutionalized operation. The establishment of a comprehensive framework, alongside coordination and quality assurance units, has facilitated more efficient management, task delegation, and improved task execution;
4. The program is conducted by a proficient academic faculty, who have obtained their qualifications and training in Western nations and possess extensive teaching experience. This ensures the high quality of the program;
5. Delivered in English, the program significantly enhances students' language proficiency and provides them with enhanced access to contemporary literature, fostering their academic development;
6. Situated in Building No. 1 within the New campus, the Department of Foreign Languages benefits from optimal infrastructural facilities that facilitate the smooth delivery of teaching activities;





7. The information system operates efficiently, enabling the centralized administration of data by the primary unit, thereby enhancing service quality and transparency towards students through online platforms;
8. The institution actively supports and encourages the scholarly pursuits of its academic staff, exemplified by the provision of financial assistance for their individual research endeavors;
9. Specialized units and procedures for student guidance and counseling are established within the institution. Furthermore, students are actively involved in decision-making processes and advisory bodies, contributing to the formulation, approval, review, and enhancement of study programs, teaching methodologies, and quality assurance measures;

b. Weak points:

1. Failure to specify the credit allocation for each course within its instructional activities in the syllabus creates a deficiency in facilitating the transfer of credits from UAMD to other domestic and international institutions; *(Standard II.1, criterion 1)*
2. The mandatory and supplementary literature across all program subjects has not been updated to include recent publications; *(Standard II.4, criterion 5; Standard IV.3, criterion 1)*
3. The absence of physical books related to the study program in the library poses a challenge; *(Standard IV.3, criterion 4)*
4. The syllabi's omission of grading information according to the American system, as required by other institutional regulations such as those governing the main unit and the diploma supplement, is noted; *(Standard II.3, criterion 2)*

Recommendations:

1. GJV recommends that the institution unify the syllabi and teaching plan in accordance with VKM No. 41 amended by specifying the credits and teaching hours for each activity;
2. GJV recommends updating the syllabi with literature from the last 5 years;
3. GJV recommends strengthening the role of the UAMD library and enriching it with more physical books of recent years, in English but also in other languages. It is also recommended to enrich the library with dictionaries for use within the library environment;
4. GJV recommends that the syllabi present information about the method of evaluation in grades and letters according to the American system, in accordance with other regulatory acts of the institution, such as the regulation of the main unit and the diploma supplement;
5. GJV recommends a combination of oral and written assessment, for the very specificity of the program;
6. GJV recommends paying more attention to the involvement of all HEI actors up to the departmental level in the budget forecasting and realization procedure as well as the criteria for access to internal scientific research funds, including support for participation in conferences or for scientific publications;
7. GJV recommends that the institution invests in providing an anti-plagiarism program for diploma works and course assignments;




Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, PROGRAMIT STUDIMIT	I TË				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI ADMINISTRIMI PROGRAMIT STUDIMIT CIKLIT TË PARË BACHELOR	DHE I TË TË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI KOMPETENCAT	DHE				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA REALIZIMIN PROGRAMIT STUDIMIT	PËR E TË				X
V. STUDENTËT MBËSHTETJA TYRE	DHE E				X
VI. SIGURIMI CILËSISË PROGRAMIT STUDIMIT BACHELOR	I SË TË				X
VLERËSIMI TËRËSOR					X

